

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME SHAQIR GASHIN

Bloomfield, New Jersey | Data: 7 shkurt 2015
Kohëzgjatja: 127 minuta

Të pranishëm:

1. Shaqir Gashi (I intervistuari)
2. Anna Di Lellio (Intervistuesja)
3. Sulejman Gashi (Intervistuesi)
4. Qazim Doda (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtesar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që jasin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Fëmijëria

Shaqir Gashi: Unë e kom emnin Shaqir Gashi, kom lindë në fshatin Vojnikë. Fshati Vojnikë i takon Drenicës, e cila rrethekohet me fshatërat tjerë si për shembull, Brojën, Kopiliqin, Turiçevcin, Kllodarnicën dhe Izvicën. Kom lindë në 1936-tën, nana m'thojke se kom lindë, kom lindë atëhere kur e kena shkru' nji arë t'madhe, ka kenë nji arë e madhe atje n'atë oborrin tonë edhe thotë që sigurisht kjo do t'jenë kah fundi i shtatorit 1936-tën.

Sulejman Gashi: Çka mban n'mend më shumë nga fëmijëria?

Shaqir Gashi: Nga fëmijëria shumë do gjana, n'qoftë se nuk i kom harrue, a din. Osht' për shembull, une jom një gjeneratë e mas Luftës së Dytë Botnore, i maj ndërmend luftërat e Drenicës. I maj ndërmend... jo krejt, po i maj ndërmend që ata burrat e asaj kohe thoshin se po bahet nji luftë e madhe n'Drenicë, "Lufton Shaban Polluzha", "Lufton Shaban Kotorri," e tanë ishin t'angazhumë në Luftën e Drenicës. I maj n'mend n'ato fshatërat atje përtej katunit të Vojnikut, për shembull Tisa, ishte nji borë e madhe, m'kujtohen sikur sot ato fotografia t'atëhershish që kanë luftu, luftojshin ata luftarët e Shaban Polluzhës.

Sulejman Gashi: Familja juaj domethanë, si ishte n'fshat? A ishte familje e madhe me shumë tokë? Për babain tënd...

Shaqir Gashi: Familja ime ishte koxha shumë ishte e njoftun. E kishim nji odë aty që vijshin burrat e krejt... muj me thonë edhe Drenicës krejt, edhe ma larg se Drenicës. E kishim nji pasuni t'atëhershish që ishte koxha i njoftun babai im, po baba im ishte... n'atë kohë kishte marrë pjesë n'Luftën e Parë Botnore. Ka qenë ushtar atje n'Luftën e Dytë Botnore përplot 13 a 14 vjet qysh tregojke me ato vujtjet e asaj luftës t'atjehit. E tani kur ka ardhë anena kena fillue gjallninë qysh m'tregojke baba atje me to. Kena pas nja dhjetë hektar tokë, jena marrë me bujqësi ma s'shumti, edhe kena pas blegtari, kena pas dhenë e dhi e lopë e kualë. Për shembull, nji kual e ka pas axha im që e msojke me pi edhe duhan me to (qeshë).

Domethonë, ishte nji kënaqësi e madhe atëherë. Kali për shembull i thirrshin nëpër darsma, që lujke kali, kur shkojshin me marrë nusen, e t'gjitha ato tjerat m'kujtohen sikur sot.

Sulejman Gashi: Kur ke fillu' shkollën?

Shaqir Gashi: Shkollën kom fillue, me siguri kom fillu' shumë vonë se atëhere nuk e dijshin mas Luftës s'Dytë, me siguri i kom pas dhjetë, dy-tremdhëtë vjet që nuk e maj n'men. Shkollën fillore e kom fillue në Turiqevc, msuesin e parë e kom pas Ahmet Mehën, Muhamrem Shatrin e tani masanena erdhën edhe do msusa tjerë, kshtu që ishte kënaqësi e madhe. Atëhere kisha nji çantë me libra, me fletore, me lapsa, ishte kënaqësi e madhe. Qatë ma s'pari kom msu' gjuhën. Atje kom msu' për shembull gërmën e parë. Ishte kënaqësi e madhe... kurrë nuk e harroj.

Sulejman Gashi: Me siguri ty t'kujtohet para se t'shkoje n'shkollë, ke pas, keni pas kafshë dele, lopë... A ke qenë çoban? A ju kujtohet?

Shaqir Gashi: Ah po po kom qenë nji kohë t'shkurtë, se kena pas afër pesëdhjetë kokrra dhi, dhenë, dele, edhe i çojshim nëpër male me kullotë. Edhe gjimin ma t'madh atëhere si çoban e kishum kur i prujshum dhitë e delet n'mëngjes i thojshum, n'mengjez i thojshum për me i pru' anena. Ishte kënaqësi e madhe. E kishum tre-katër qenë që na i rujshin bagëtinë, edhe ka kenë shumë interesant ajo.

M'kujtohet sikur sot ishte punë e madhe... me pas, për shembull, pasuninë e madhe. Ata fshatarët tonë atje n'katun, ata ma s'shumti jonë marrë me blegtari, kanë pas dhi, dhenë, lopë, bullicat i kena pasë. E kështu me rradhë, ajo pasunia jonë, qajo ishte ma s'shumti. Edhe me bujqësi sigurisht, edhe me mjelljen e grurit, e t'misrit, e tonë atyne gjanave që u dufshin me....

Baba im edhe ne të gjithë merreshim ma s'shumti me bujqësi, me blegtari si thash edhe ma përpara, me dhi, me dele, me lopë, e me kualë, e me bullica m'kujtohet e tjerë. Shkolla fillore kur kom fillu' atje si thash edhe ma përpara ishte nji kënaqësi e madhe, megjithëse ishum vanu' atëhere. Populli nuk ka pas shkollë t'madh, dikush përpara meje ndëgjojsha se kanë pas pasë nji shkollë atje që e kanë msu' në gjuhën serbisht, kurse ne fillumë në gjuhën shqipe. Na erdhën do libra nga Shqipëria, kurrë nuk e harroj atë gjimin e madh t'atëhershët edhe kështu me rradhë fillojshum. Kshtu që shkollën fillore e kreva atje n'Turiqevc.

E tani masandena ishin do gjana tjera, ishin mundsitet, nuk ishin t'lehta po për neve ishte nji... nji fukarallak i madh, për arsy se n'aso kohe i lypshin edhe ato tepricat e ashtu qajtuna si višak që i qujshin ata serbët. U duhke me dhanë të tana gjanat, deri te voja, pula që e bon vonë u duhke me ia çue qeverisë t'atëhershme.

Kshtu që, i maj ndërmend edhe ato vujtjet tona, fukarallakun tonë, se qysh fillum, filloj fukarallaku. Menihere kah '48-ta, '49-ta po simbas kujtimeve t'mija, m'duket se viti ma i vshtirë ka qenë viti 1950, t'cilin asaj kohe e maj nërmend, sikur na fmitë ka dy-tre mujë ditë s'kena pasë bukë me ngranë. Por e maj n'mend që e bojshum bukën me lula t'dillit, vetëm e vetëm për me mujtë me qëndru', me ekzistu'. Asaj kohe i kishum, e maj nërmen i kishum njo pesëdhjetë kokrra dhi, tamël kishum boll. E marrshum kokrrat e kallamoqit, e bojshum tamël për me mujtë... edhe lulat e dillit i përzijshum për me mujtë me nejtë gjallë. Kshtu që, ishte shumë e vshtirë ajo koha e atëhershët, tani ata na i morrën dhitë tona edhe n'atë kohë kurrë nuk e harroj, e kena pas dhitë shumë t'mdhaja, nji numër shumë t'madh t'dhive. E i çunë atje

n'Mitrovicë e bojshin çka bojshin nuk e di, por neve na i murrën të tona dhitë edhe na lanë gati sakat pa pronë pa kurrgjo. U duhke me çu edhe mishin, u duhke me çu edhe vojën, edhe tlynin, e pulën, e... çfarëdo gjaje që e kena pas n'prodhim, t'prodhum n'bujqësi, u duhke me ia dorëzue shtetit t'atëhershëm.

Eh tash kujtimet e mijë atje n'katun që t'thash përpara, osht' aty katuni im aty Vojniku i ka pas dikun qysh thojshin atëhere, afër nji qind shpish. Por asht' shumë interesant edhe asht', edhe tham kto me bindje, se për shembull kanë kenë tona fiset n'atë katun, kanë kenë Gashi, Krasniqi, a Hoti, Berisha, Thaçi, të gjithë tjerët. Po osht' shumë interesante që kurrë s'ka pasë ngatërresa n'mes veti. Për shembull kur dalshum n'bujqësi me i punu' arat tona atje, e kena pa që e kanë pas njëfar zakoni u bojshin t'ashtuqujtun orët. U bojshum ka njizet, tridhetë vetë. Prej tri-katëdhetë vetë shkojshim nji ditë te njani, nji ditë te tjetri, ishte njifar kënaqësie e madhe, njifar lezeti i madh.

Tani për shembull, burrat e asaj kohe bisedojshin, me siguri bisedojshin nga ana e qeverisë, kur s'i kanë besu' atje shtetit jugosllav. Mas Luftës së Dytë Botnore, pleqtë e asaj kohe ata gjithmonë menojshin se s'kanë me pas nji jetë t'gjatë. Për shembull... ishin do rregulla n'arat tona kur u bojshin, prashitshim kallamoqin t'ashtuqujtun, kishte lezet t'madh. Tani për shembull blektorinë... kur shkojshim atje me çobanë e kena pas njifar tradite që e bojshim, i thojshim kulaçi. Kulaçi zakonisht u shtrojke diku kah shmitri kur ia u nalshum mëngjezin qi u duhke me çu bagëtinë gjithë ditën me kullotë, e atëhere ishte... e vjelshum atë tamlin e deleve edhe i përgatitshum ma t'omlën për dimën dikur. Ishte kënaqësi e madhe, tani për shembull, kulaçin sot e qitsha une, nesër e qitke Qazimi, nesra e qitke Hasani e kështu me rradhë e kishum një kënaqësi, një lezet t'madh. Për shembull,[i pakuptim.] nga pesë-gjashtë javë që shkojshum secili musafir te njoni-tjetër me pite, me pula, me tona gjellat e tona që i kena pasë, ishte lezet i madh.

Tashti për shembull m'kujtohet edhe ato... për shembull si çoban që m'pytët ma përpara, i kena pas do far lojnash atje, lujshum i thojshim 'kliçkas', 'petas', edhe i kishim do... Tani ishte ma interesante kjo ishte qi, i kena pas nji gjueti, kur shkojshum edhe ma t'mdhej se na që ishum t'ri, u matshin me atë gjueti, për shembull na e qujshum Sokol. Skyfteri vijke përmi atje nér neve edhe rrijke përmi, e zogu kur dojke me hi dikun nëpër ato therrat, ai hijke aty kshtu qi u tutke. Na shkojshum edhe i thojshum njoni-tjetrit "Lema mu tash," na e gujshum me gurë, ishin do zogjë koxha t'mdhaj. Kshtu qi ishte njifar hovi, njifar kënaqësie e madhe, interesant ka kenë.

Tani kur e marrke për shembull ai skyfteri, sokoli që i thojshum na, e marrke nji zog e nxajke ai vetë edhe e çojke n'atë zgordhën e vete, na e çujshum i thojshim, "Amanet, hajde apet!" "Amanet, hajde apet!". A m'beson që ai sokoli, vijke meniher e fluturojke përmi neve. Ajo ka kenë një kënaqësi e madhe që kurrë s'mund t'a harroj. E kështu me rradhë kam pasë edhe shumë gjana tjera. Si t'them, për shembull nëpër fshatëra tjera, ana jonë që e majnë në mend, atëherë ma s'shumti qitash se përpara jonë marrë me bujqësi. E për shembull ishte ajo koha kur u majke krejt vera, e i bojshin ato darkat e Lamës që i thojshim edhe ajo ishte një kënaqësi e madhe. Tani për shembull vjeshta marrke diçka, po pruje edhe diçka tjetër, e kshtu qi u përgatitshim për dimën.

Për dimën ka qenë marifeti ma i madh që t'i bojsh drutë e dimnit, t'marrsh laknat me shti turshi, speca, edhe ai që e kishte mundësinë m'e pre nji pasthërm. Për shembull pasthërmja kur u prejke, na mujshim me e nda pasthërmen, e thirrshim tanë kojshitë, ishte lezet. Tani, masanena kur e honkdhim darkën lujshim kapuqas. Nis'shum me knu' njoni-tjetrin. Ka kenë lezet i madh edhe me t'vërtetë kto s'mund t'i harroj kurrë.

Rinia

I kom kujtimet e ushtrisë, na përpara se me shku' ushtar, na si t'thash përpara neve na murr ajo vala, fukarallaku atje, skamja e ku ta di une. Kshtu qì m'u duftë gati m'i ndërpëre shkollën krejt edhe me shku' diku me lypë punë nëpër ato sipëmarrjet e asaj Jugosllavisë t'atëhershmit. E shkojshim punojshim punë t'krahit, domethonë ata na shfrytëzojshin se qysh kishin qef. Dikur masanena mu m'erdh letra për me shku' ushtar. Une shkova ushtar atje, ushtrinë e kom bo në Shkup edhe n'Tetovalez, e maj nërmen termetin e Shkupit kur ka kenë... n'cilin vit ka kenë ajo?

Sulejman Gashi: Në '63-tën.

Shaqir Gashi: N'63-tën (qeshë), n'63-tën ka qenë viti edhe ka qenë shumë katastrofë e madhe. Tani une si ushtar e maj nërmen edhe nji detal do t'a tregoj ktu. Une atje kur shkova ushtar... ata m'çun në shkollën si infermier, kshtu që kom qenë dikun kah 13-14 mujë e kom kry një shkollë t'infermierit edhe u bona koxha njifar infermieri t'cilib m'qujshin masanena edhe doktor. Dhonshim gjylpona e ku ta di unë. Edhe tani ushtar, ishte shumë interesant ushtria. Ushtria nuk e kishim tana t'drejtat, po ka kenë diçka pak ma nryshe ushtar atje.

Nji here kurrë nuk e harroj, ishte aty n'Tetovalez nji magazinë e barutit atje ku ta di unë. Edhe ata kapetanat e atyne, asaj armatës t'atjeshit, po thojnë se ky Gashi osht' ka bon sefa kshtu nën armatën jugosllave, "Le te çojmë n'rojë, n'strazhë t'ashtuqujtun [Serb. straža]". E m'çun mu n'atë rojen atje ku ish nji magazinë e barutit e cila që ishte n'dy drejtimet kishte të drejtë me thonë "Ndalo!" vetëm në nji drejtim kishte të drejtë me thonë, "Ndalo!" në të tjerat, qit pushkë, bo diçka. Kshtu qì, ata ishte edhe njifar droje e atyne ushtarëve se vijnë e t'mysin disa roja e ku ta di une, kur n'ato roja përpara s'i kom pasë, s'e kom pasë naj eksperiencë.

Kur... ndodhi nji e keqe, por tani për mu ishte e mirë. Iшин pas lidhë do gomarë atje n'Tetovalez, nijsha pleqtë e asaj kohe që thojshin "Si gomarët e Quperlisë" (qeshë). Sa... kurrë nuk e harroj kit gja. Edhe ata ishin pas lidhë bisht për bishti edhe kshtu qì unë n'vend se mos me thanë "Ndalo!" unë prapë e përdora atë fjalën "Nalu!", "Nalu!" e ata gomarë nuk u nalun. Une e dheza automatin edhe e kisha pas vra atë gomarin. Kshtu qì bohet nji tollovi e madhe, vijnë krejt ushtarët e thotë, "E ke vra armikun" a ku ta di, e m'i dhanë nja dhetë ditë me shku' në pushim.

Kurrë nuk e harroj ato, n'ato dhetë ditë pushimit që kom shkue, babi im ka kenë smutë, edhe n'atë vit ka vdekë. M'kujtohet ushtria ishte e ranë, e kishte nji diciplinë shumë... por ishte edhe nji eksperencë për njerëzit qi e kryjshin atë ushtri atje. Une kur e kryva ushtrinë, ata ma dhanë njifar diplome të cilën kisha të drejtë me, m'u marrë me atë infermierllakun, medicinë a ku ta di unë, ata e qujshin si "bolniçar" të asaj kohe. Kshtu qu menihere mas n'kryte t'ushtrisë, morra marrëdhanie pune me Demer Kapi. Në Demer Kapi aty ishin nja pesëqind punëtorë shqiptarë, n'Maqedoni, n'Demer Kapi, që u bajke ajo magestrallja Xhevxheli - Demer Kapi - Xhevxheli edhe Shkup. Edhe kshtu qi ishim nja, thash përpara nja pesë qind shqiptarë e kusur.

Po m'kujtohet nji detal i madh ishte Seth Leqani me djalin e vet dhe kurrë nuk e harroj, kur e kishim pushimin ai marrke kangë patriotike, u nalshëm të gjithë e ndigojshum, kurrë nuk muj ta harroj atë knaqësi. E tani, masanena, mas Demer Kapisë, vjen tash puna koxha si e vshtirë edhe mu m'transferojnë m'çojnë n'Mitrovicë. Pej Mitrovicës vjen nji urdhën atje dikun edhe m'thojnë, "Ki me shku' n'Janjevë t'Prishtinës". N'Janjevë t'Prishtinës prapë i kishin çu njo katër-pesë qind puntorë të gjithë qi thejshin gurë me njifar vendi atje, edhe tash isha i obligum si infermier, e kisha nji makinë për emergjenci që ndodhke noj gja tjetër, nji Kryq t'Kuq {prek krahun ku Kryqi ishte i vendosur} me do farë lidhësash, me kqyrë për higjenë apo çka po ndodhë atje.

Kur, në nji kohë nuk kishte ma tepër se dy mujë ditë, vjen nji kolonel i Beogradit edhe tash ai pe sheh disa... nuk ishin pastru' mirë ata shatorat ku ishum dhe po thom, "Kush o' ktu i kujdeshëm për këtë pastrim?" I thotë dikush, "Osht' Gashi" për mu'. Edhe vjen ai koloneli, kurrë nuk e harroj edhe po m'thotë, "Pse ky far [i pakuptim.]?" Edhe po m'thotë "Rri gatitun!". Une i thash "Shiko..." u duhke me i thonë shok, shok kolonel, i thom, "Une ushtrinë e kom kry", s'kom nevojë me nejtë gatitun". Thotë, "Ti e paske krytë e ashtit. Prej kahit je?" ma bon mu'. Prej asaj kohe drenicakët me thonë t'vertetën, nuk mujshim na me kallxu' shpesh me thonë që jemi prej Drenice, u mshefshum. Se Drenica ishte n'sy t'keq nga ata UDB-ashat, ata regjimi i asaj kohe, e thash, "Une jom nga Mitrovica". Tha "Mitrovica, Mitrovica! Po tregom prej kahit je?" Unë tani p'i tham, "Jam prej Serbisë, ose i thojshim Skenderajit". "Ah..." tha, "ti te k'je prej Drenice!" Thash "Po prej Drenicës jom," tha "Ju t'Drenicës nuk na doni neve". Une i thashë, "Ty shok kolonel, në qoftë se ju nuk na doni neve, s'kem arsyen na me ju dashtë juve". Kshtu që ai u idhnu' me atë fjalë e tha, "Une t'përashtoj prej pune menihere". Thashë, "Qitashti!" Edhe kshtu që kurrë nuk e harroj, ishte vjeshta ia kom dorëzu' ato mobilitet çka i kisha si infermier. I kom dorëzu' e kom shku' n'Mitrovicë, jom shkarku' prej asaj detyre dhe kom shku' në fshatin Vejnikë.

Prej fshatit Vejnikë, tashi masanena kah me ia majtë nuk dijsha. Gjithmonë derisa hijshum në Demer Kapi e krejt msheftas e ndigojshum Zanin e Amerikës. Andrra jonë ishte, po nuk ishte e sigurtë sesi mujna me dalë n'Amerikë; po, ajo dikur u realizu'. E cilat jonë... tregojnë pak ma vonë, kshtu që vendosa për me marrë atë rrugë. Për me marrë atë rrugë u duhke njihere me marrë do rrugë tjera. Për shembull në atë kohë në Kosovë nuk u dhashin pasportat, nuk u dhashin kurgjo, rrijshin mrena. Nuk lajshin me dalë jashtë, por une vendosa me shku' n'Mal t'Zi. Edhe shkova n'Mal t'Zi aty dhe punova disa punë tjera. E tani prej atyhit msova se qysh me mujtë me dalë në Shtetet e Bashkuara t'Amerikës.

Osht' shumë interesant, n'Ulqin, n'anë t'Malit, n'Krajë, n'zona n'Malsi t'Madhe, kishte njerëz shumë t'mirë, ishin shqiptarë t'mirë e m'kujtohet se edhe ata t'shkretit u munojshin me ditë atë gjuhën. Ishte nji urë atje që i thojshin "Ura e Gurit" prej asaj Urës t'Gurit deri n'Ulqin ata nuk dijshin as serbishtën mirë vetëm shqip, po ata u munojshim me përzi ato shqipen e serbishtën bashkë. Kshtu qi, m'kujtohet ajo vjeshta kur e kom lanë Ulqinin, dikun ka kenë e '68-ta. Kurrë nuk e harroj, për me dalë n'Shtetet e Bashkuara të Amerikës i vetmi njeri që e ka ditë që po shkoj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka kenë profesor Kajtas Fazlija.

Ai erdh prej Kosovës atje edhe m'përcjelli, kurrë nuk e harroj ishum n'Tivar. Tani, po nalna pak n'Tivar, m'kujtohen do detale tjera. Do t'ju tregoja nji detal tjetër, për shembull n'Tivar ju e dini se ka kenë masakra e Tivarit. Une si thashë përpara u njoftova me fshatarët e rrethit t'Tivarit atje, kurrë nuk e harroj osht' nji fshat që quhet Peçuricë, nji fshat tjetër osht' Zalev. Edhe une u njoftova me njifar Bajram Suloviç i thojshin, se ata me "viç-a" u thirrshin tanë, se osht' interesant ai veni aty kanë kenë as boshnjakë, as turqi, as shqiptarë, por e kanë folë gjuhën diqysh ni sy. Edhe une u bona miq me ta edhe ai i kishte nji qind copa dele t'u i ru. Dhe nji ditë po m'thotë, "Djali jem, n'gjuhën serbishte po du me t'tregu diçka", thom "Urdhno?". Tha, "Kur ka kenë ajo masakra e Tivarit, neve na dhanë urdhni që me i lidhë qentë," thotë, "na e kishum nji qen shumë për marak, e lidhum qenin. I qitshum qenit gjellë në hambar, kur u bonën 15 ditë qeni nuk u lajmru' kërkun". Edhe thotë "Edhe nji ditë vendosëm me shku' me kqyrë çka ka qeni. Kur e kqyrum në hambar, qeni ish bo qishtu dyfish {tregon me duar}, vetëm skeleti i kish mbetë. Ngat qenit ish kan nji neri i luftës, për shembull t'asaj masakrës t'Tivarit i cili e kish hangër gjellën e qenit". Edhe ai plaku po m'tregon asokohe, tha, "S'kom ditë çka me ba, me grabujë e kom marrë e kom nxerrë atë njerin, e kom qitë përpara e e kom thirrë poicinë. Kur i kom thirrë policinë..." ai plaku i asaj kohe e kishte nji shtagë krrule kshtu {tregon me duar} edhe ishte çoban i deleve. Edhe thojke, "Qitu e kom thirrë policinë, qitu i kanë ra allti". E ishte kjo dhimtë e madhe!

Kur isha n'Tivar atje e n'Sutomore, na ishum si argatë t'krahit aty. E ishum disa shqiptarë që ishin n'punë, n'sipërmarrje aty nërmjet Tivarit edhe Ulqinit. Por ne ishum në një rrugë atje që u ndërtojke. Ishuëm dikun kah pesëdhetë a gjashtëdhetë shqiptarë. Në nji kohë na shqiptarët qysh e kena pasë zakon, gjithmonë marrshum kangë e knojshim tulifar kangësh. E m'kujtohet nji detal shumë interesant, nji malazeze ish t'u i ruitë dy lopë atje afér detit t'Adriatikut n'Tivar edhe po thotë, "Qyre, qyre qysh po knoni! Si muneni me knu' këtë kangë që une e maj nërmen. Ma shumë ka pas plisa t'bardhë ktu n'deti, se qj ka galeba". E na u mërzitëm. Domethonë ajo e lidhke me masakrën e Tivarit që u ba. Të gjithë e dijmi se çfarë masakre ka qenë aty. I kena pasë na edhe prej katunit, e kena pas njifar Maksut Hasanin që e ka marrë pjesë e u pshtu nëpërmjet Krajës, e anës t'malit, dikush i ka pshtu'.

U bona mik me njifar Sulo Bajramoviç prej fshatit Peçoricë, ai i kish dikun kah nji qind copa dele, se ma s'shumti majshin dhenë, dele që ju thojmë na. Kshtu qi ni ditë ai po m'tregon, nji ndodhje lidhur me masakrën e Tivarit. Ai po m'tregon se, "N'kohën kur u bo ajo masakra, neve na erdh urdhëni me i lidhë qentë". "Asaj kohe" thotë "i kisha qentë e dhenëve që i rujshin, po edhe kisha nji qen tjetër për marak. Edhe na u duftë me i lidhë, e murëm e lidhëm qenin, na i qitshim gjellë qenit si zakonisht në hambar. Por ajo lidhja e qenit u ba dikun kah 15 ditë... ajo ishte arsyaja," qysh thojke plaku, se ka pas shumë xhenaze

nëpër rrugë që i kanë vra, i kanë masakru', kshtu që mos t'dihet, mos t'bohet kjo punë ma e madhe. Edhe po m'tregon ai, po thotë, "Një ditë m'bjen n'men për qenin du me shku me kqyrë sesi osht' qeni". Kur u gërbav në e ka kqyrë në hamar, e ka pa qenin që vetëm skelet. Edhe tregojke ai plaku i asaj kohës, "E merr njifar grabule edhe e nxerr atë qenin, po ish kanë edhe nji njeri, nji shqiptar sigurisht kosovar-shqiptar i cili e kish përjetu' masakrën atje, ai e kish pas hongër gjellën e qenit. Kshtu që ai m'tregojke thojke, "Vetëm skeleti që i kish metë atij njeri. Kom marrë me grabulë edhe e kom nxjerrë prej nën hamar edhe meniren e kom thirrë policinë. Policia kanë ardhë, i kom tregu' kshtu, kshtu, a mujnë me pshtu' kit njeri", tha "n'vend t'pshtumit, i ranë pesë herë allti. Qitu, qitu {tregon me duar ku e kanë gjuitë} e kanë shti n'dhe!

Andrra jeme edhe andrra e disa shokëve t'mi aty për aty ishte se qysh me dal neve n'Amerikë. M'kujtohet, edhe njihere p'e përsërisiti, isha përgatitë me dalë, si thashë ma përpara i kisha disa miq nga Ulqini. Edhe fillum, ishte njifar Fadil Çapriqi atje edhe për detale, ishte baba i Richard Lucas i cili sot osht' nji sukses i madh, osht' nji biznis i madh, osht' nji aktivist i madh që kanihere mburrna se ishte sebep, se babën e tina me disa shokë tjerë, u formum shtatë familje e vendosëm për me dalë në Itali. E për me dalë në Itali neve u duhke me marrë rrugën me marrë nji autobus t'ashtuqujtun Raketa dhe shkum deri n'Rijekë.

Prej Rijeke aty, e pijtëm ka nji kafe... po kurrë nuk e harroj ajo n'Rijekë, na atëherë për shembull n'Kosovë, neve atëhere e folshim atë fjalën shok, "Ku je shok?", e zotni s'e përdorim. Une kur shkova n'Rijekë aty, ishte nji kroat aty edhe i tha "Shok!", kurrë nuk e harroj atë fjalën, ai tha, "Nuk jom shok, nuk i kom rujtë loptë me ty, po jam zotni!". Kshtu që, m'u dukë pak liri ma e madhe atje n'Kroaci e n'Rijekë. E tani prej atyhit, na e pijtëm ka nji kafe edhe vendosëm se qysh me dalë, kah me dalë. I kishum disa orientime, ishum kah shtatë famili edhe e thejmë kufinin e dalim në Itali.

N'Itali kom qenë n'kamp, i thoshim Patriçan, nji ven i kampit ku ishte nji ven i kampit qaty tonë njerëzit ishin qaty që u përgatitshin për me shku'. Kurrë nuk e harroj se për shembull, na n'atë kohë nuk guxojshtim me thanë se jemi prej Kosove, se na kthejshin se gjoja kosovarët i kanë do t'drejta pak ma t'mdhaja se n'Shqipëri, po jem prej Shqiprisë. Po unë u pata lajmru' se jom prej Shqipnisë, bile sot e atë ditë kanë metë edhe dokumenta prej nji fshatit Belaj nga Shkodra që kurrë s'kom qenë, as s'kom ditë, por ata msojshin se qysh me thonë. Edhe, kurrë nuk e harroj, për me dhanë atë testin ishte nji kroat. Edhe ai tash po m'thotë, "Kthe shpinën", une p'e kthej shpinën atje e serbishten e dijsha goxha mirë edhe po i përgjegjna n'ptyje serbisht. Thotë, "Ti nuk je nga Shqipëria, se ti p'e din serbishtën shumë mirë". Une i thom "Zotni, une i kom pas dhjetë vjet kur kom dalë prej Shqipnisë, n'Jugosllavi deshtën me ma dhonë nënshtetsinë e Jugosllavisë, unë nuk e pranova". Thom', "Une... për dhjetë vjet edhe gomari e kish msu' gujhën serbishte, se jo une!" edhe m'thotë, "Hajde, ik se une e di kush je ti" (qeshë).

E tani prej asaj Patriçanës kena shku' në Capua Caserta afër Napolit. Kena nejtë njo nantë mujë ditë, edhe prej atyhit kena vazhdue në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Osht' interesant në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për me ardhë na nuk kishum asnji informacion. Atje ka pasë... une besoj se n'atë kohë ka kenë edhe nji prej Kosovës, prej Rugovës, që me t'vërtetë nuk e kom pa kurrë. Sadri e ka pas emnin, kurrë s'e kom pa masanena. Edhe une i vetmi kom kenë prej Kosovës. Shumica e migrantave të asaj kohe ishin

shqiptarët malësorë të cilët ishin dalë me krejt familjen, edhe ishte shumë interesant, se po kthehem pak mrapa. Për shembull, shqiptarët e asaj kohe që dalshin nëpër Llogore t’Italisë ata u duhke me pagu’ një shumë t’madhe për me marrë një pasaportë e për me i hipë atina, asaj anijes atje “Barbari” që shkojke në Itali, ia dhajshe. Kshtu që malazesët e asaj kohe, jo që e shpërblejshin shqiptarët po edhe kishin edhe përfitime t’veta se marrshin pare. E kshtu që tani, nuk e kishim na naj informacion. Aty ishin tri-katër kategori se me cilin don me shku’, e ku don me shku’. Aty e kom pasë... Mentor Qokun e kom pasë njoftë. Ai ka qenë një patriot i madh me Vasal Antonin e ku ta di unë.

Edhe tash na u përgatitum, na dulën letrat për me ardhë në Shtetet e Bashkuara, kurse neve i kishum disa informata se po erdhëm n’Amerikë, ti duhet me pas naj armë me veti se përndryshe ka gangstera, ka zezakë, ku ta di une, “Kanë me t’vra, kanë me t’plaçkitë, kanë me t’bo...” E tash për me mujtë me u mbrojtë kshtu, vendosëm secili dikush me i marrë ka një pistoletë me veti (qeshë) që i thojmë na allti. Me t’thonë t’vërtetëtëne une me dy alltija kom zbritë midis Kennedy Aeroport. N’atë kohë kur kom zbritë n’aoportin e Kennedy’s ktu, ka kenë një Nerim Kupi, ai ishte i obligum, ashtu i ngarkum që me ardhë me na përcjellë naj emigrant që vijshin n’asaj kohe. Edhe vjen atje, po i jepin disa sheja që diçka nuk o’ n’regull me mu. Edhe po m’thotë ai Nerimi po thotë, “Gashi,” se e kisha njoftë ato që ish ardhë përparrë n’Itali. Ishum njoftë përparrë me Nerim Kupin, ka kenë burrë i mirë. Sot osht’ dikun n’Shqipëri me siguri, edhe po m’thotë, “Ma jep mu alltinë se une di që ti je prej Drenice e ki marrë alltinë me veti”. Une po i thom, “Shiko more s’muj se e kom shumë n’ven t’keq. E kom mshefë alltinë, s’muj t’a kallxoj”. Kshtu që tani m’thojnë ata që i kqyrshin ato shejat, thojnë, “Çele valixhen!”, kur e çeli valixhen ishin kan disa arra n’valixhe. Edhe ata ma lojnë që jonë arrat edhe kshtu që une dola edhe erdha në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (qeshë).

Atëhere prej aeroportit erdhëm drejt e në Bronx, në Arthure Avenue ku sot jonë shumica e shqiptarëve. Atëhere n’atë kohë e kisha një mik Lam Halilin prej Ulqinit. Ai kishte pas pague apartmentin tem një dy-tre mujë ditë përparrë se me ardhë une prej frigës që nashta s’mujnë me gjetë apartment. Edhe tash fillum na, ishin ardhë disa njerëz përparrë, e kom pat njoftë njifar Riza... Halili ka kenë prej Krajës, me to jom pas njoftu’ në Ulqin. Ai ka pasë ardhë një nji vit e ma tepër përparrë meje. Kshtu që une i lypsha ata shokët se ku muj me gjetë, sesi muj me gjetë punë. Po na nuk ishum t’përgatitun nga gjuha englze nuk dijshum. Edhe kurrë nuk e harroj, fillum tash me dalë prej Bronksit edhe me ardhë n’Manhattan m’u shëtitë. U shëtitshum nëpër rrugë të mdhaja.

Tani dikur na tregun se duhet me shku’ nëpër agjenci atje t’gjojmë punë. Tash kur shkova në agjenci për me lypë punë, tha, “Çka din me punu?” ma boni njoni. Thom’, “Jom si murator,” se isha njifar sipërmarrësi atje në Sutomore që thamë ma përparrë, e t’i tregoj që diçka me punu’ kshtu. Eh, tash ai e merr vesh që jom njifar skulptori. “Ah” thotë, “kem punë për juve”, kshtu që thotë, “hajde se t’gjejmë punë”. Edhe m’çon me njifar veni aty dikun, kur shkoj te ai punëdhanësi që kish nevojë për punë, ai kish kuptu’ se jam skulptor, aty ishin do gurë që u duhke me i bo. Ma boni, ma tregoi planin aty, une s’marrsha gjo vesh edhe po i thom, “Jo, jo kto gjana nuk i di, une jom murator”. “Ah,” thotë “m’falë!” edhe m’çoi

n'transport. Kshtu qì punën e parë qì e kom pasë aty, m'u doke zashëm, bile ju kom thonë i kom bo Zotit gjynah që kom ardhë ktu. Po t'u kthejsha....

Sulejman Gashi: Cili vit ishte kur erdhët?

Shaqir Gashi: Me në '70-tën, n'fillesë të 1970-tës, '69 e '70-tën. E kshtu qì ishte e zorrshme. Hajde ku me gjetë punë, çka me ba, shëtitshum, nuk dijshim ku me gjetë punë, ka pasë punë asaj kohe, kur po m'digjon nji shok atje po m'thotë, "Osht' qai Rizaja" që e përmeni i ndjeri, ka vdekë, ka kenë shumë burrë i mirë prej Krajës. Thotë, "Ai t'a gjen nji punë," ai ish i punësum n'pastrime. Edhe kurrë nuk e harroj dikun në Rizolli Bookstore, nji librari e Rizolit e njoftun në Pesë Avenu m'merr me punu'. Mirëpo, ai bosí i tijna i kish pas thonë që, "Merre atë punëtor, por mos t'vjen heret edhe le t'delë ma heret që mos te shohin kta". Domethonë, gjashtë javë ditë kom nejtë gati pa punë hiç. Kur ma n'fund t'fundit e morrëm vesh që ai bosí i atijna i kish pasë gënjen e kish pas rrejtë që unë s'isha njeri i regjistrum n'punë.

Eh tash ishte nji idhним i madh, nji gajle e madhe, tash çka me bo. Ata tash po m'msojnë mu', "Ki me shku' n'drejtori dikun në Madison Avenue" e tridhetë rrugë, në t'cilën e kom pas edhe nji restorant aty, shumë mirë, Zana u qujke nuk e harroj kurrë. Edhe kshtu qì, shkova atje, e çka me i thanë atijna bosit t'madh, tha thuj, "Please, help me!". A m'besoni që e kom shkru' n'dorë {tregon si e ka shkru në duar} "Help me please." Edhe kom shku' atje i kom tregu' atijna, "Help me please!", nuk marrsha vesh kurgjo. Tha, "Po ti nuk je i regjistrum. E qitash me t'nihmu! Po mirë, ti çfarë gjuhe flet ti?". Une menojsa se e dijsha serbishtën, menojsa se serbishtja e rusishtja jonë gati njisoj a din... afërsisht diçka afër. Thashë, "E di edhe rusishten," "Ah," tha "shumë mirë, se e kemi nji inxhinier në Hotelin Leksington". E tash po thom n'Hotelin Leksington ka kenë, thojnë Mit'hat Frashëri thojnë qì ka vdekë n'atë hotel, masanena e morra vesh, edhe mu' m'dërgojnë te ai.

Aty ai inxhinieri nuk ish kenë rus, po ish kenë prej Estonisë. Edhe une përnihere shkoj i thom "Govorite ruski," ai u gjet i nënçmum. Thotë "Zotni, une nuk jom rus. Po m'nënçmon". Thom "M'fal, po çka je?", tha, "Une jom estonian. Po ti?", thash "Une jom shqiptar". "Mirë, mirrem vesh, po une rus nuk jam". Ai ishte ken nji gjenerall i armatës të asaj Estonisë t'atëherit, se Estonia ka pas dalë gati si... krejt aparati shtetnor ka migrue n'Amerikë se nuk e kanë pranu' kurrë atë okupimin e Rusisë. Kshtu qì me t'thanë t'vertetën ai m'pat nihmu' shumë, shumë m'pat nihmu' aty. Edhe une fillova punën në atë Hotelin Leksington, edhe ditë pér ditë ai estonian që m'msojke ka dy-tri fjalë englisht, dhe kshtu msova.

Nji ditë, n'atë hotelin ku punoj ishum aty, isha si *busboy* edhe u duhke me pastru' diçka n'atë Hotelin Leksington. E kisha edhe nji koleg aty, zezak. Ai kur e kishum pushimin e marrke *New York Times*-in e qitke përpëra e lexojke, une s'marrsha gjo vesh. E tash po munohna m'i thonë atijna kolegut tim, atij zezakut se edhe une i di shumë gjuhë, po kta s'di me lexu', nuk e kuptoj po me lexu' e lexoj, po me kuptu' s'e kuptoj. Edhe po m'thotë, "Çka din ti?", thom "Une e di, flas shumë gjuhë". "Cilën gjuhë?", thom "E flas serbishten, e kroatishken, e bullgarishten, e italishten, e rusishten". Ai e murr atë *New York Times*-in kshtu e thotë, "*Listen to me my friend*. N'qoftë se ke ardhë n'Amerikë, n'Amerikë edhe Zoti e flet englishten. Po nuk e dite englishten as lutjet e tua Zoti s'ti pranon." E tash thom "Oh, po u duhka me e msu' englishten sa ma

shpejt". Punoj një kohë e thash përpara krejt vllaznitë kena kanë miq, n'shkollë bashkë e n'rininë tonë ato krejt edhe i thom' t'ma pagun nji Rilindje sa ma shpejtë, bile t'kom diçka me lexu'. Kshtu qì Kajtaz Fazlija ma paguji Rilindjen e asaj kohës, kshtu qì me rradhë me ditë për ditë e lexojsa edhe kqyrsha se çka po ndodhë në Kosovë.

Kshtu qì, tani, masanena, ia nisa me msu' gjuhën e ku ta di une e tani me rradhë po du me kërkù' punë tjera. Shkoj me nji agjensi me kërkù' punë, edhe ai po m'thotë... kjo ishte përpara Leksingtonit gati. Edhe po m'thotë, "I ki *delivery boy*", me ato porositë për shembull *delivery kur* i thotë dikush për ushqim me ia çu n'shpi. Une nuk e kuptojsha çka domethanë *delivery boy*. Po thom, "P'e pranoj kit punë". Edhe shkoj dikun kah Wall Street area, kurrë nuk e di *tash exactly adresën*. Kur shkoj aty, aty sigurisht ka kenë nji grek a nuk e di kush, edhe e kish porositë dikush njifar *bagedhe* m'a bjen aty. Une po menoj, po thom', "Ky tek o' burrë i mirë!" po thom'. Po don mas pari me dhonë me hongër, tani me m'a gjetë punën me punu'. Une krejt ato që ia kish porostë dikush tjetër, une e marr edhe e ha për veti. Edhe ai tash m'a bon me gisht, "Hajde me çu tjetrën edhe m'i jep pare". Thom', "Une s'kom pare, une kom hangër", (qeshë) "Çka ki hangër?", kshtu qì m'çitën prej punës krejt, edhe ishte shumë e vshtirë ajo punë.

Po ma n'fund t'fundit, masi shkova n'hotel Leksington me punu' aty, nisa gjuhën ka pak, ka pak me msue. Edhe mas shtatë mujve, tetë mujve i bona nji sasi paresh aty, ishte nji rrögë e mirë, edhe ai gjeneralli i Estonisë po m'thotë, "Tash, e kom edhe nji punë tjetër për ty". Thashë, "Çfarë pune?" thotë "Osht' nji i ashtuqujtin *super*. A don me ardhë atje? Osht' konsullata e Estonisë, e me ardhë ti aty. Po t'dojmi shumë, e po kom qef me shku' me punu' aty!".

Kshtu qì tani prej Bronksit, mas tre-katër-pesë mujë dite, shkova në Manhattan edhe u bona *super* [ang. shtëpiak i banesës] në atë Estonian House e ashtuqujtin, në atë Shpinë e Estonisë aty. Edhe tash aty po nxia' goxha miq, e ku ta di une. Po m'kujtohet edhe nji detal aty, për shembull atë shpi e kish pas vizitu' edhe Milan Xhivos... Millovon¹, e kish pas vizitu' atë shpi aty edhe kish pas lon nji libër për kujtimet n'atë librarinë e tyne. Se aty nuk banojke kërkush, vetëm une e kisha atje naltë banesën. Bile aty nalt pat ardhë edhe Kajtaz Fazlija i asaj kohe të m'vizitoi atje, po do t'tregoj pak ma vonë. Edhe kshtu qì une tash p'e marr, nuk e dijsha gjuhën serbo-kroate edhe p'i lexoj tash atë librin se çka i ka thonë baba i Gjilasit Millovari, çka i ka thonë kur i ka ra Isë Boletinit. T'u e lexu atje, thotë, "la çitëm pritën te Ura e Podgoricës", i thotë shokëve t'mij, "Une kom qef me nxon gjallë Isë Boletinin, mos m'a vrani!". "Po kta shokët e mij prej tute", thotë "e paskan zgju' me pushkë edhe e paskan vra". Mirëpo, ky tani ka shku' shpejtë për me nxanë

¹ Milovan Xhilas, politikan, autor dhe disident jugosllav. Ndonëse komunist dhe kishte luftuar si partizan, Xhilas u bë një nga kritikët më të ashpër të elitës komuniste jugosllave. Ishte udhëheqës partizan deri në vitin 1954 kur u përjashtua nga Partia Komuniste. Ishte Zëvendës President i Jugosllavisë dhe u konsiderua si pasardhës i mundshëm i Titos. Publikoi vepra të rëndësishme kritike ndaj komunizmit si Klasa e Re: Një Analizë e sistemit Komunist (1957), që e bëri me fame në Të Majtën e Re të Evropës Perëndimore. Publikoi biografi shkencore letrare, dy vepra autobiografie dhe romane.

gjallë e kur ka shku' aty, ai thojke, "E tha nji fjalë shqip, e m'jetë marak se nuk e di çka tha". Osht' shumë interesant kshtu.

Për shembull mas asajna që isha *super aty*, tuj shëtitë, tuj msu' diçka ma tepër, tuj shëtitë rrugës e shkoj dikun kah pesëdhetë rrugë atje në t'Dytën Avenu, Second Avenue që i themi sot edhe ishte kenë nji restorant Pizza aty, e kishte emrin "Dibra", njifar Beqir Previzi, edhe une tani hina e i thom "Po a je shqiptar?", "Po!", "Po t'marr lakmi që e ki këtë restorant kaq t'bukur". Thotë "T'a shes këtë restorant!", thom "Po sa m'a len more kit restorant ti mu?", thotë "15 mijë dollarë". Thom "Po s'i kom une 15 mijë dollarë". Thotë sa i ki?", thom "I kom njo pesë-gjashtë mijë dollarë!", thotë "Ami ti mu qato pesë-gjashtë mijë, tjerat i pres". Kshtu qì në moment e bona njifar *deal-i* me to, njifar pazari, edhe une u bona pronar i ni restorantit. Une e hjeku "Dibrën" edhe si prej nostaljisë e vuj emnin "Drenica". "Drenica" a din pesëdhetë rrugë, nuk ishte larg prej Kombeve të Bashkuara. Kshtu që, tani më rrallë kur e bona "Drenica" ia nisën shqiptarët që kishin emigrue gjatë Luftës t'Dytë Botnore edhe para Luftës t'Dytë Botnore si për shembull Rexhep Krasniqi, Luan Gashi e Lekë... si e ka emnin ai Leka... Agim Leka e të tjerë, e ishte Sahit Kryeziu.

Po, m'kujtohet, kujtimet ma që kurrë nuk i harroj janë... Luan Gashi. Luan Gashi sigurisht e dini se ka kenë një intelektual i retepë dhe ka kenë nji anti-jugosllav, anti tona gjanat që u bojshin ato gjana. Ai ka pas dalë me atë Ballin Kombëtar me Lidhjen e Kosovare e ku ta di une. Masanena e msova krejt historinë e tijna, unë e pata ndigju edhe ma përpara. Edhe ai tash kur p'e sheh "Drenica" atje, po çuditet, po thotë "Si munet me kenë 'Drenica'?". Vjen te unë edhe po m'flet mu englisht. Thotë "Çka u...? What does Drenica mean?" "Une nuk e di, Drenica, Drenica!" p'i thom. "Po kah je ti?". Ai tani filloj me folë shqip. Thom "Nga Kosova!" "Po cilit vend Kosova?", thom "Nga Drenica". "Po si e ki emnin?", po thom "Shaqir Gashi", po thom "tek jem edhe kushëri". Kshtu qì, ditët e para, kurrë nuk e harroj qì jom njoftue me Luan Gashin e asaj kohe, edhe ai gjithmonë ka pas ardhë n'atë restorantin tim. Edhe nji ditë kur u njoftum pak ma mirë, vijke ma shpesh edhe po m'thotë "Si po t'doket ty Amerika ktu?" Thom, "Amerika po m'doket shumë mirë. Po, e kom nji problem?" Tha "Po çfarë problemi ki?", thom, "Nuk po muj me msue gjuhën englishte. Hala s'po di mirë m'u gjetë". Thotë "Kadale kusher, se fmija n'bark t'nonës po s'nejti nantë mujë, ai del pa vakt. Ti veç sa k'i ardhë po don me ditë englishten perfekt. Kshtu qì, me t'vertetë ka qenë knaqësi e madhe, vijshin shqiptarët qashtu prej atij restoranti, u njoftojshum... ishte shumë interesante, që s'kishum ni kurrë për ata njerëz. Vijke Sahit Kryeziu, Rexhep Krasniqi qì thash përpara, Mexhit Dibra. E tani ma vonë dikur na, dikur kah '72-shi, '71-'72-sha, ia boj ni garacion Kajtaz Fazlisë edhe vjen prej Kosovës e drejtë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Aty kur vjen, e takoj kte e krejt ata që ishin kundra Jugosllavisë, po ky Kajtazi i asaj kohe nuk u tutte bash fortë, po e kish nifar kujdesi. Kshtu qì, m'kujtohen shumë do gjana interesante..."

Tash mas Drenice, mas Drenices, tani ia nisëm me bo goxha do punë t'mira, ku ta di unë, ishte qiraja pak... nuk ishte e shtrejtë. I bojshum do pare, u njoftum me shqiptarë. E maj n'men se kur kena fillu' me shitë atë pjesën – *slice of pizza* që i thojmë na, ishte 20 centi, une e bona 25 centi (qeshë). E çova çmimin në 25 centi.

Kshtu që tani mas atij restorantit pata sukses t'madh edhe e hapa nji tjetër restorant në Tre Avenu në shtatë rrugë, tetëmdhetë rrugë të cilën ia hodha emnin "Trepça". Në "Trepçë" e kom shumë kujtime, aty ishte, n'asaj kohe m'patën disa intelektualë që ishin atje me marrëdhhanie pune, të Jugosllavinë atëhere. Për shembull, qysh ishte ky Osman Gashi, e nji ditë ai Osman Gashi e kish pas pru Ukshin Hotin, Ukshin Hoti i kish thonë ktu n'Amerikë me studiu diçka kriminalistikën simbas ton asaj hesapi që nuk i di une. Edhe, ka ardhë aty n'atë restoranin "Trepça", Osmani ka dalë diçka jashtë, ai ka nejtë me nji tavolinë aty edhe po m'shikon mu, thotë, "I kahit je ti?". Thom "Unë jom nga Kosova" "Po cilit vend t'Kosovës?", thom "Une jom nga Drenica!", thotë, "Me çka merresh ti ktu?" Tash e kisha une njifar mendimi, qiky tek o' pak si arrogant, çka merrna une ktu... thashë, "Une zotni merrna me restorant, merrna me ushqime, me kto gjana". Tha, "Hajde ulu ktu drenicak se nuk du me m'u marrë me vetëm me restorant, po du m'u marrë edhe me çeshtjen shqiptare". Kurrë nuk e harroj bisedimin që e kena bo me to. M'kujtohet... kurrë nuk e harroj kur m'ka thonë, "Na shqiptarët i kena dhonë 226 gjenerala t'ushtrisë Turqisë, e veten e kena lonë sakat". "Une du ti me u angazhu në aktivitetin e kombit shqiptar, se ktu osht' Amerika, osht' demokraci, du m'u marrë..." Edhe me t'thonë t'vertetën, prej asaj kohe, ajo dikah kah '74-'75, '75 sigurisht, prej asaj kohe kom pas nji inspirim t'madh. Dhe tani herën e mramë që e kom pasë pa Ukshin Hotin, kom pasë marrë pjesë në Lidhjen e Prizrenit, kshtu qì Pajazit Nushin e falemnderoj edhe sot. Atëhere asaj kohe ma bon nji ftesë dhe m'nderoi dhe kom marrë pjesë në Lidhjen e Prizrenit për 100 vjetorin e Lidhjes t'Prizrenit atje n'Kosovë. Çka me t'thonë për tjerat? (Buzëqeshë) Pytëm për disa tjera... (qeshë)

Lufta

Ma vonë veç dulë Ushtria Çlirimtare e Kosovës. M'kujtohet vizita e parë kur ka ardhë ai Xhavit Haliti me Azem Sylën. Kena dalë i kena pritë. Na kanë tregu krejt se Ushtria Çlirimtare e Kosovës osht' e vërtetë, "Nuk jonë terrorista, po dojna me luftue, me çlirue," knena e anena... E m'kujtohet për shembull, ato fushatën e parë patëm shku n'Bruklin për me mujtë me marrë diçka pare, mirëpo krejt ata biznismenat e asaj kohe kishin frikë se kështu n'Amerikë ishte njifar etiketimi, njifar lajmi i keq se ata janë terroristë. Po n'fund t'fundit, kurrë nuk e harroj ka konë ai[e pakuptim.] atje në... prej ka kenë njifar dëshmije, kom pasë rastin me shku atje n'Kongres edhe erdh, kështu që u hekë ai etiketimi që nuk janë terroristë, por që luftojnë për pragun e shpisë, luftojnë për pamvarësinë.

Edhe m'kujtohet kur jena kthy tani, krejt fuqia janë e diasporës shqiptare ka shkue në anën tjetër, domethanë ka shkue ka Ushtria Çlirimtare e Kosovës, gja që domethanë çdo shqiptar ka dhonë kontributin me pare, edhe fizikë... e kena formu këtu Klubin, aty Batalionin e Atlantikut që edhe sot i kemi tre herojë vëllaznit Bytyqi.² Sot i kena pru këtu edhe i përkujtojmë vit për vit. E kështu me radhë, nuk po di

² Vellezërit Bytyqi (Ylli, Agron, dhe Mehmet) shtetas amerikan me origjinë shqiptare iu bashkangjiten Batalionit Atlantiku për të luftuar me UÇK-në. Pas marrëveshjes së paqes të vitit 1999, ata u pajtuan që të shoqëronin disa fqinjë romë për në Serbi. Por kur e kaluan një kufi të papërcaktuar afér Merdares, ata u arrestuan nga policia serbe për hyrje ilegale të Jugosllavisë së asaj kohe. Pasi që e vuajtën dënimin, ata u ri-arrestuan dhe në mbrëmjen e 9

çka me thanë, po du me thonë prapë se për shembull kanë kenë shqiptarët që kanë kontribu shumë. Unë ti përmeni vetëm pak, po thashë përpara malsorët s'guxoj me i përmen me emra se jonë shumë, por do të përmeni Zgjim Xhemën, Rexhë Xhaklin, Bruno Selimaj, Din Derdin e disa të tjera që kanë kenë aktivë. E kena pasë edhe ate Sami Repishti i cili ka kenë i penës e i hesapit. Domethonë, une thomë që për atë kohë Lobi Shqiptar e ka lu një rol kryesor për çështjen shqiptare n'tanësi.

Sylejman Gashi: Gjatë luftës n'Kosovë n'vetin 1998/99 shumë njerëz i kanë pasë familjet e tyne atje, edhe ju i keni pasë i keni pasë familjen në Vojnikë, kishit kontakte me ta?

Shaqir Gashi: Lufta osht' shumë interesant, 1997-tën ishte kështu Festa e Flamurit qaty afér dikun e kisha një restorant dikun në Madison Avenu në krye t'rrugës atje dhe një mik i imi me t'thonë t'vërtetën ai Hys Shkreli ma boni ni telefon e tha, "A din çka po ndodhë Gashi? Ju drenicakët e fillutë edhe një luftë". Tash une po menoj mos u bo far shaka a hajgare që po thojmë na. "Po, po", tha, "e keni fillu ni luftë". Kur ma n'fund t'fundit kur e mora vesh se ai kushërin jem Abedini Sandokani,³ e shprazi pushkën e parë publike kundra serbit edhe prej atyhit e teposhtë fillunë u shumunë edhe filloj lufta kundër. E kena përkrahë me mish e me shpirt, kena pasë edhe idhnlime. Kena ndëgju që u ba për shembull masakra e Lukshanit, e komandantit legjendar Adem Jasharit, e ajo e Zbicës e... tana na kanë mërzitë që ka bo vaki që s'kena mujtë me fjetë ka 24 sahat.

Sulejman Gashi: Me 17 shkurt shpallet pavarësia e Kosovës n'2008, tash do t'bahan shtatë vite. Si e përjetutë këtë ngjarje?

Shaqir Gashi: Këtë ngjarje e përkujtoj ni gjësim ma t'madhin n'jetën teme. E kujtoj për arsyen se kjo ishte një luftë gati një qind vjet (buzëqeshë). Domethanë ishte një luftë të cilën ata njerëzit që kanë luftu edhe përpara, m'shkojke ndërmend thojsja që s'kanë mujtë m'i përjetu tash këtë shpalljen e pavarësisë se na përpara e kishim një kërkësë vetëm Kosova Republikë. E tani prej Republikës u ba e pamvarun krejt, ajo ishte ni gjësim i madh. Edhe e maj nërmen kur dulëm atje n'Time Square shqiptarë diaspora e Nju Jorkut, Nju Xherxit e krejt çka ishin me teknologjinë e re u murrën vesh, kenë me mi 10-15 mijë vetë t'u celebri në Time Square. Krejt policia e asaj kohe e krejt Shtetet e Bashkuara të Amerikës na urojshin e na përkrahshin shtetin e madh.

Aktivizmi

korrikut 1999, ata u lidhën me tel dhe u ekzekutuan me pushkatim në qafë. Kufomat e tyre u nxorrën në qershori 2001 nga një varr masiv në fhastin Petrovo dhe u dërguan në Jonkers, Nju Jork. Prokurori serb për krimet lufte i akuzoi dy police pë transportim të vëllezërve nëper Serbi, por që të dy u shpallën të pafajshëm në vitin 2012.

³ Abedin Rexha, i njohur me emrin e luftës Sandokan, ishte një komandant i UÇK-së nga Vojniku. Ai u vra në vitin 1998 gjatë një shkëmbim zjarresh me luftëtarë të tjera të UÇK-së.

Tani mas atij restorantit “Trepça” që e pata hapë, u zgjanova pak ma tepër edhe hapa nji restorant tjetër t’cillit ia ngjita emnin “Kosova”. Ajo ishte e regjistru me si “Kosova” por kishte emnin “Il Galetto” e cilla ka pas lujtë nji rol shumë t’madh, do t’bisedojmë pak ma vonë për to. Edhe asaj kohe dikun kah e ’78, ’79-ta nisen me ardhë disa përfaqësi të Kosovës atje, ishte siç thash përpara Osman Gashi, Riza Visoka, Bardh Pula, Ali Kryeziu e ku ta di une. Të gjithë ata që vijshin nëpër restoranta tonë, nëpër restorantat e mi. N’atë kohë nuk kishte asnji restorant shqiptar përpës meje, kshtu që me t’vërtetë e një veten krenar. Edhe e kisha nji knaqësi atëhere edhe sot jom shumë i gjushëm i knaqun, e një veten krenar se fillova gati si ma i pari, po tani dikur u shumumë por do t’bisedojmë pak ma vonë për kto.

M’kujtohet dikun kah e ’77-ta, ’78-ta nuk e di, e kishim nji restorant atje e qujshim “La Triestina”, a m’besoni që Triesta ma pat çu nji shpërbirim prej atjehit që ia kom vnu emnin Triesta. Nuk ishte bash... njërit nuk e dijshin, nuk n’ë njofshin, as s’u dijke ku asht’ Kosova, ku asht’ Shqipëria. Eh tash fillova me vnu atë emnin Triesta se e kisha nji nostalgi se kisha dalë prej Triestës, kisha ardhë në mërgim ktu. Asaj kohe vijke baba e nji Chevy Chase i cili ishte bashkëpunëtor me John Belushin. John Belushi edhe atëherë kom kuptu’ por edhe ma vonë, ai e kishte ba me famë djalin e tijna. Nji ditë vjen baba i tijna aty në restorant edhe n’atë restorantin që e kisha u dufke me kenë pak ma i veshun ku ta di une, mu m’vijke keq me i thanë se nuk e dijsha edhe baba i kujna asht’, vetëm kisha ndëgju që ish artist. Edhe p’i thom. “Hajde t’ë qes nji drekë dikun, me nji restorant tjetërkun”. Edhe e marr e çoj në nji vend tjetër atje ma afër i cilli u qujke “Galina”, edhe po bisedojmë. Po m’thotë mu, “Ju italianët e keni menjen e madhe”. Une p’i thom, “Zotni, plot respekt po unë nuk jom italian, po unë jom shqiptar. Unë jam Albanian”. “Ku asht’ Shqipëria? Çka asht’ ajo Albania?”. Thom, “Zotni, osht’ shumë keq për juve kshtu që nuk e dini për kombin shqiptar që ekziston”. “Pse m’i ditë?”, thom “Ti duhet me ditë ma shumë se kërkush”. “Pse,” thom “John Belushi djalin t’ë ka bo me famë... edhe ti tash nuk e din”. Thotë “John Belushi nuk osht’ shqiptar, osht’ italien”. Thom “Zotni, ai osht’ shqiptar. Jo që osht’ shqiptar, po osht’ edhe kushërin im”.

Edhe kshtu që, me nji fjalë gati lidhem si me kusht me to (qeshë) edhe ai shkon i tregon Chevy Chase edhe i thotë, “Nji njeri po thotë e ka kushëri John Belushin, osht’ shqiptar.” Thotë “Po babë, shqiptar osht’”. Edhe ai kur vjen m’kérkon falje mu edhe ai djali i tijna i Chevy Chase e John Belushi, e t’ja nisin me ardhë artista. Domethonë prej atëherëshit m’ka metë ky emën, edhe sot e përdori Gashi Belushi. Osht’ shumë interesant. Për shembull n’asaj kohe, nuk e dishin kto gjana.

Kshtu tani me rradhë mas ’79-tës, n’80-tën që tash përpërpara vijshin kta përfaqësitet e Kosovës, vijshin nëpër restoranta tonë, u njoftojshin. Domethanë t’vërtetën për shembull unë kam kujtime shumë t’mdhaja edhe me Ali Kryeziun edhe me Bardh Pulën edhe me do tjerë që vijshin, bisedojshim tek tanë për punë për çashtjen shqiptare, domethanë. Ata u tutshin ka pak, na kallxojshin gjana që çka po ndodhë. Po ma në fund t’fundit kur ndodhën demonstratat e 1981-shit, atëhere ne diaspora u zgjumë prej gjumi edhe u dufke me bo diçka.

Um kujtohet, kurrë nuk e harroj, n’atë natë ka qenë aty Bajram Bytyçi, ishte drejtor i fabrikës së Suharekës dikun. Edhe ai kishte me u kthy atje, ishte shumë i mërzitshëm. Kshtu që, tash demonstratat ishin bo, na

nuk ishum të organizum bash fort se ktu tash edhe ma përpara, kur kom ardhë ma s'pari ktu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës jena taku' për shembull me ata emigrantë që kanë dalë në luftën apo para luftës. Ata e kishin nji mendim tjetër, na e kishum nji mendim tjetër. Për shembull, kur ia nisshum me diskutu' me folë diçka për çështjen kombëtare, na e dojshum Shqiprinë se ishum marrë atje, po aty na nuk dijshum me i da dallimet. Për shembull, ma vonë e kuptum se ata emigrantat e kahershëm, ata ishin kundra ideologjisë. Kurse ne menojsnim se kta nuk pe dojnë Shqiprinë. Edhe ishin disa marrëdhanie të dobta nërmjet veti. E kshtu qi, kur dulën demonstratat, kur nisëm m'u bashkue, fillun edhe demonstrata e ku ta di une, edhe m'kujtohet nji detal shumë interesant. Tash asaj kohe me t'thonë t'drejtën isha mirë me biznise, i kisha punët shumë mirë, edhe n'asaj kohe ishte ky Ramadan Xhemë, vllavi i Xhefë Xhemës i cili ka kontribu' shumë për çështjen kombëtare. Edhe vjen ai aty nji ditë me atë... me do tjerë, shokë tjerë, edhe po m'thotë, "Çka me ba? Lufta filloj n'Kosovë, osht' e pamundshme!"

Me thonë t'vertetën, asaj kohe nuk e di a e thashë përpara, na ishum disa shqiptarë që i kishum fillu' disa kontakte me misionin shqiptar... pra me Kombet e Bashkuara. E tash asaj kohe e maj nërmen kur ka kenë ktu Abdyl Baleta, unë edhe Bruno Selimaj - për t'cilen kom respekt t'madh se ka kontribu' shumë, të gjithë shqiptarët e dijnë kontributin e tijna - edhe vendosëm tash dojmë me shku' dikun me bo diçka, m'u konsulltu me Misionin zyrtar se lufta po fillon. Na ishum pak naivë me t'thonë t'drejtën (qeshë). Edhe shkum kurrë nuk e harroj te Abdyl Baleta atje, ai na nxerri prej Misionit atje, na shkum me nji darkë. Tha, "Kadale se kto punë i din shteti shqiptar, i din partia e punës, i din Enveri, i din kto gjana. Mos u ngutni n'kto gjana". Kshtu qi, na metëm gati si naivë pak. Ishte shumë interesant se për shembull, Bruno Selimaj kish pas dalë nihere n'Shqipëri atje kshtu qi e dijke terrenin e neve na marrke menjë që na t'shkojmë t'shkojmë tash Bruno e une kah Drenica, ai nga Plava e Gusia kshtu qi t'shtijmë armë n'Kosovë. Po ajo ishte pak... {hap krahët} (qeshë), po ashtu ishte koha asaj kohe.

Edhe kshtu qi, fillumë tanë me bo diçka. Çka me bo, tek me bo? Nji ditë, une edhe Ramadan Xhemë thotë, "Dojna me bo diçka!" "Çka me bo?". Thotë, "Dojna me bo, me njoftë Kongresin Amerikan në Senatin se çka po ndodhë në demonstratat e '81-shit në Kosovë. Çka me ba tash, si me marrë? Ajo ishte ajo rinia kosovare n'mërgim, Taher Krenanja n'atë kohë punojke n'do gjana n'tcilën kom pas respekt e kom pas nji bashkëpunim me to shumë t'madh. Na e murrëm disa kopje t'tijna edhe n'emën t'asajna, n'emën t'rinishë kosovare n'mërgim, shkum edhe i çum 500 telegraama. Atëherë s'ka pasë faks, 500 telegraama, 500 kongresmenave edhe 100 senatorave se t'u ia shpjegu se po ndodhë nji gja e keqë në Kosovë. Jonë kah i torturojnë studentat, jonë kah i burgosin studentat e kshtu me rradhë. Edhe tash shkum te nji post office dikun kah Pesë Avenuja, unë edhe Ramadan Xhemë, edhe shkum tash aty edhe ai ishte Irish n'atë postën atje. N'aso kohe irlandezët i bojshin demonstratat t'vetat, edhe ai gati na kuptojke se çka po ndodhë me neve, a din (buzëqeshë).

Kshtu qi, tash me t'kallxue shuma sa na kushtun, noshta nuk osht' mirë, po dikun kah 3500 a 4000 dollarë i pagum ata telegraama që i çumë drejtperdrejti kur kanë ardhë kongresmenat e senatorët, i kanë pas nëpër tavolina se çka po ndodhë n'Kosovë. Edhe une jom i bindun se prej asaj kohe që i kanë marrë ata telegraama, kanë fillu' diçka ndryshe me menu' për neve. Për shembull, une i mbaj ndërmend do

demonstrata kur i bojshim, nuk na lojshin bash fort m'u zgjanue, i kishim do dallime. Se propaganda jugosllave ishte shumë e fortë asaj kohe, e kishin nji miqësi shumë t'madhe ndaj Jugosllavisë dhe Shteteve t'Bashkume t'Amerikës. Por, kshtu me kohë dalë kadale, na fillum disa demonstrata, ishin për shembull shqiptarët që kishin ardhë prej... për shembull mas meje, a ku ta di une. Po du me thanë edhe kit gja, se une besoj, dikush m'ka thonë që une jom bon vaki i treti a i katërti prej Kosovës në Shtetet e Bashkuara t'Amerikës që kom emigr'u ktu në Amerikë.

Po, e maj nërmen vetëm njifar Ymeri ka kenë prej Prishtine, edhe njifar Muharrem Broja ka ardhë ktu, se të tjerët nuk i maj n'men. Kshtu qj, ia nisen me ardhë kadale dale, t'u u shpërngulë prej atjehit, e t'u i përgatitë, mirëpo gjithmonë me nji frigë. E ka pas shqiptarë prej Kosovës që kanë dalë n'ato demonstratat e para gati me maska, qj mos m'u pa se ishte e rrezikshme gjithmonë na menojsrum se do t'kthehem atje n'Kosovë, do t'bajmë diçka, do t'bahet pak ma mirë, por situata u keqësotje sa ma shumë edhe me ashpër. E kshtu me rradhë...

E qashtu ia nisëm me dalë nëpër demonstrata t'u u aktivizue, t'u u njoftu' a ku ta di une. Por dikun kah e '85-ta, '86-ta e patëm nji fat tjetër. Në nji ditë, në nji fushatë që ishte për Bushin, për Bushin e moçëm, për ish-Bushin, atje kishin fushatë për to. E shkojnë disa shqiptarë atje marrin pjesë. N'atë fushatë aty, ish kenë Joseph Diogardi me babën e tijna atje. Edhe t'u bisedue e nin atë babën e tijna t'u i folë disa fjalë shqip arbëreshe edhe kshtu qj ky Ramadan Xhema, ka kenë i kujdeshëm edhe i ndigjon ato fjalë edhe thotë, "Po, kadale se ky folka shqip!". Kadal dale, mirren vesh se baba i tijna dijke shqip, gjuhën arbëreshe me folë, po ku Joseph Diogardi që e gjetëm ma vonë, ishte djali i tijna edhe kshtu na u njoftum. N'aso kohe ky ishte kongresmen. Edhe tash Ramadan Xhema vjen e m'tregon mu thotë, "Kemi nji lajm t'mirë, se kena gjetë nji kongresmen arbëresh me emrin Joseph Diogardi, e duhet me bisedu me to edhe m'u aktivizu' me kqyrë çka po bojmë me pasë lidhje". Edhe i thomë Ramadanit menihere me ma pru' n'restorant Joseph Diogardin, edhe kshtu qj nuk e harroj, hera e parë kur u njoftum me to, ai nuk ka pasë noj lidhje shumë për çështjen shqiptare t'thom t'vertetën. Edhe sot e asaj dite tash duhet m'i dhonë nji kompliment vetit, po une jom krenar me to, thotë, "Prej Gashit kom msu' se m'ke eduku' për gjendjen e shqiptarëve se qëndron Shqipëria e Kosova në krejt trojet etnike". Kshtu qj, kadal dale e bonëm njifar miqësie me atë Diogardin.

Po tash situata n'Kosovë ditë për ditë vijke t'u u keqësue. Tash na nuk e kijshum nji kapacitet t'madh me t'thonë t'vertetën, që thash propaganda jugosllave ishte shumë e fortë. Se tash përpara në restorante u tubojshim edhe bojshim llaf se çka mujna me bo na tash. I bojshim hesap tona senet që nuk jemi n'gjendje nuk kemi kapacitet, e ku ta di une. Atëhere duhet me bo dikush, me formu' nji *lobby*. Domethanë e bojshim prej *lobby-t* n'*lobby*. Domethonë nuk ishin do gjana t'sigurta. Kshtu qj nji ditë, dikun kah, ma vonë kah e '89-ta, tubohen disa shqiptarë biznismena t'asaj kohe që i kishum puntë pak ma mirë edhe bisedojimi. Edhe me Diogardin them se me Diogardin, t'posaformum nji *lobby* shqiptar nashta t'i nihmojmë çështjes shqiptare. Kshtu që ishim nja pesë-gjashtë vetë n'fillesë, t'cilët i lidhëm dorë për dore, besë për besë se do t'punojmi për çështjen shqiptare, kombëtare shqiptare, n'veçanti për Kosovën. Kshtu qj n'atë kohë m'kujtohet ishte për shembull Diogardi n'restaurantin Bruno e kanë formu

lobin shqiptar. Shyqiri Selimaj se ma vonë, nuk fola për Brunon, se me Brunon kom shumë gjana interesant me folë për to (buzëqeshë).

Kshtu që e formum *lobby-n*, lobi i parë që e formum ishte Xhim Xhemaj, ishte Din Derdi [pakupti.] Dedi, Bruno Selimaj, Mitch Thomas, Samuel Prishteva [pakuptim.] edhe une. Kshtu që e fillum aty edhe ne menihere e prunëm se DioGardi, na nuk e dijshum se DioGardi tha, “Na ma s’pari duhet me ditë konceptin se si punon Shtetet e Bashkuara, n’qoftë se e msojmë na konceptin atëherë na mujna me i kontribu’ çështjes kombëtare”. Na u msumë prej tijna, me t’thonë t’drejtën Diogardi ka meritat e veta, osht’ histori n’veti që une muj me thonë që ka kenë shumë, shumë e nevojshme dhe e qëllume kur u formu’ lobi shqiptar, Lidhja Qytetare Amerikane-Shqiptare n’krye me Joseph DioGardin. Tani vijnë ato, fillumë me bo demonstratat, ai filloj tani me shku’ n’Kongres edhe me aprovu’ rezoluta. M’kujtohet sikur na sot që kena nisë aktivitetin ma t’parin e që e kena nisë dikun n’Park Avenu, kena kenë nji grup, i kom edhe ato fotografijat muj me ia u tregu’ kur të doni. Kena fillu’ me D’Amatos, me senatorin D’Amato i cili ishte miku ma i mirë i shqiptarëve n’kohën ma... n’kohën e orëve t’para. E kshtu me rradhë tani ia nisëm me nxanë miq, shkojshim u bamë tani me Robert Dolin e ku ta di une.

Por, ishte ma interesante nji gja tjeter tani ma vonë, bojshim demonstrata, protesta, domethanë pranë Kombeve të Bashkuara na u patë bo si shpija jonë. Po u bojke nji javë, a dy javë, a tri javë që nuk shkojshim aty, na u duke diçka çudi. Domethonë, s’ka pas javë a ditë që s’kena shkue nëpër demonstrata. Kena pas probleme n’demonstrata, për shembull ishte ajo situata e flamurit me yll edhe pa yll, e cila ishte shumë e rrezikshme, edhe gati-gati dijke m’u ba edhe njifar aksidenti. Po, dikur t’gjithë shqiptarët, kur ishte çeshtje kombi shqiptar ramë dakord se me ardhë me ylla a pa ylla, qysh t’dush vetëm dil n’demonstrata (qeshë). E tani, dikun kah ’89-ta DioGardi ma boni nji telefon, tha kom qef që me t’njoftu’ me nji kongresmen i cili quhet Tom Lantos osht’ kongresmen demokratik prej Kalifornisë. Thotë, “E kem nji takim, dikun n’Yonkers edhe dëshiroj që t’shkojsh ti atje”. Tash na ishim tubu’ disa shqiptarë, aty ishte edhe Zani i Amerikës. Ishim tubu’ do shqiptarë aty, tash secili diskutojke, ata nga Shqipëria e kishin qëllimin se qysh me rrzue Shqipërinë sa ma shpejt, domethonë ideologjinë (qeshë); kurse, nji grup tjeter që ishum, n’këtë anë knena (tregon me dorë) na nuk dojshim me na prekë n’Shqipëri, na dojshum diskutimin vetëm çeshtjen e Kosovës. Kshtu që, mu m’respektun qashtu që isha gati ma i moshum, edhe m’ulën ngat kongresmenit Tom Lantosit edhe ngat bashkëshortës t’sajna [të tij] Anetës, kurrë nuk e harroj, kom kujtime t’mdhaja me to. Edhe kshtu që nisëm me bisedue, tash ai po m’pytë mu asaj kohe une i kisha tre-katër restoranta, n’Manhattan, edhe Tom Lantosi po thotë, “Kto jonë Shtetet e Bashkuara t’Amerikës, kjo osht’ demokracia ktu, për shembull Gashi ka fillu’ si busboy tash i ka tre-katër restoranta, kjo osht’ Amerika, kjo osht’ demokracia”, e ku ta di une.

E tash ishin disa shqiptarë që e murren fjalën nga ana e Shqipërisë që thash ma përpara, krejt i dhashin randësinë ma shumë Shqipërisë se Kosovës. Une e mora fjalën edhe i thash “Une dëshiroj, që të bisedojmë sot ktu për çeshtjen e Kosovës, për arsyen se Kosova osht’ e okupume. Shqipëria osht’ e okupume prej vetvetit, edhe besoj se dal-kadale ata kanë me u rregullu’. Por qëllimi jonë osht’ kryesor se Kosova osht’ e okupume, po bohen gjenocida, po i përashtojnë studentat, p’i shtijnë nëpër burgje, po

vijnë ushtria, p'i vrasin ushtarakët ata që kanë shku' në sherbim atje, a ku ta di une. Edhe kur e kreva atë muhabet atje, po thotë "Zoti Gashi, p'e dojshe Shqipërinë shumë". Thomë, "Po zoti kongresmen e du, se osht' shteti amë i imi". Thotë, "Dëshira jeme sot osht' për me shkelë kamë në Bulevardin e Tiranës". Tash une {dëftون kah vetja} kur po thotë "me m'shelë kama", po m'shkon menjë thash mos po don me okupu Shqipërinë (qeshë). Eh na nuk i kutpojshum do gjana, edhe une pak u mrrola. Edhe ai m'diktoi, tha, "Shiko, nalu, ktu. Ti ke menu' keq, unë nuk menoj me shku' si okupues por si mik". Ai i lidhke disa kujtime me Hungarinë se ai ka qenë me originë prej Hungarisë atje. E tash une, kur ma shpjegoi ato se osht' dëshira për me shku' në Shqipëri, une duke u bazue se kisha disa marrëdhanie me Misionin Shqiptar, thomë, "Ndigjo kongresmen, t'a jepum fjalën se kama jote ka me shkelë e para në Tiranë". Edhe une prej atyhit e lajmrova DioGardin edhe me një gjim t'madh po shkoj drejt në Misionin Shqiptar, po thomë kshtu, "E kom një ptyje shumë t'rëndësishme edhe ne duhet me aprovu' kit gja". "Si, çka ka?", thom kshtu kshtu i tregoj "Osht' mirë me shku' m'i ba marrëdhaniet m'i nisë marrëdhaniet me Shtetet e Bashkuara t'Amerikës se edhe i nihmojmë Kosovës, edhe osht' mirë me Shtetet e Bashkuara t'Amerikës me bo marrëdhanie".

Ishte Bashkim Pitarka n'atë kohë m'kujtohet, ambasador aty, thotë, "Shiko kadal-dale mundet me kenë kjo gja edhe e vërtetë, duhet t'kqyrim, t'bisedojmë. Shoku Gashi mos u ngutë, do t'cojmë ty me një grup n'Shqipëri". Se tash përpara ia nisen do lëvizje, ishin pak do sheja që Shqipëria i kishte dhanë do sheja që duhet me bo diçka, duhet... (qeshë) po ndodhë diçka. Edhe kshtu qi për mos me zgatë, u duhke me punu' n'atë gja shumë për me mujtë me çu Tom Lantosin, një vjet a dy vjet, se p'i bjen tash kah e '90-ta. Në '90-tën ju e dini të gjithë se e bonën një atentat në Enver Hadrit n'Bruksel. Ai ishte një lider i asaj kohës menjihere mas Jusuf Gërvallës, ishte i aktivist i madh po ato e vratjën.

E tash une, disa shokë ktu se e kishum formu' atë far lobin shqiptar. I kishim disa t'dhana t'mira, na u kish rritë pak autoriteti, shqiptarët na përkrahshin të gjithë diaspora pa marrë parasysh e Nju Jorkut a e Kalifornisë, a Çikagos a ku ta di unë. Dhe kshtu qi, ju thomë, "A do t'shkojmë n'vorrimin e Enver Hadrit?" Ai m'ndigjoi mu edhe u përgatitëm une, DioGardi, Tin Derdi dhe Rexhë Xhakli. Edhe i kena hipë aeroplanit edhe kena shku' n'vorrimin e Enver Hadrit n'Bruksel. Kur kena shku' n'Bruksel, e aty për me... se idea jonë ishte lobi shqiptar ishte që të kemi kontakt me diasporën e Evropës. Kur kena shku' atje e kom pas njoftë vetëm Musa Hotin, njerin e kanë vra tash vonë kom ndigju' edhe i bana telefon atijna se na jemi ktu me kongresmenin e me Lidhjen Qytetare Shqiptare t'Amerikës, thotë, "Hajde na viziton". Na shkumë n'Sheraton Hotel edhe kur jonë bo një sahat, ma tepër se dy mijë vetë na kanë rretheku n'Hotelin Sheraton, domethonë që kanë ardhë me aq vullnet m'u pa me neve. E tash aty bisedum se çka me bo, ishte funerali. Edhe kshtu qi kur jena çu t'nesërmen na atje, kurrë nuk e harroj, unë isha me një dhomë me Din Derdin. Din Derdi kur e flas fjalën e tijna, emnnin e tijna do t'hotë se qaj njeri ka kontribu' shumë, shumë për Kosovën, edhe une besoj se Kosova i ka borxh një falemnderim për to. [I drejtohet intervistuesit] Çka u ba? (qeshë dhe qan) {thith llullën}.

Sulejman Gashi: Po pushojmë pak.

[Videoja ndërprehet, intervistuesi dhe të intervistuarit bëjnë pauzë.]

Shaqir Gashi: Tash kur jemi te aktiviteti i shqiptarëve me miqtë tanë që i nxumëm në senat dhe kongres, m'kujtohen disa detale. Ne e banëm mik Robert Dolin të cilin të gjithë dijmë se ka qenë gjithmonë edhe akoma osht' mik i shqiptarëve. N'1938-tën u ba nji fushatë se dojke për m'u bo president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Edhe ai ishte prej asaj partisë republikane, ai ishte kundër Bushit t'madh. Sa m'kujtohet ktu meritën e ka ma s'shumti Xhim Xhema e kurorëzoi njifar vend që i thojmë na, nji kerr t'madh edhe me flamuj amerikanë e shqiptarë e krejt e qënisëm shumë mirë, u nisëm në Nju Hempshir e nejtëm atje gati nji javë. Jonë shumë disa gjana që i maj n'men, për shembull shkojshum atje nëpër Nju Hempshir ishte borë e madhe, kurrë nuk e harroj.

Po, ktu do t'i jepi nji meritë ma s'shumti se na ishim edhe me malsorët e Malit t'Zi e tash m'i ia përmen emnin tonve. Ka kenë nji Luigj Canaj, Zefë Kalaj edhe disa të tjerë, tash nuk m'kujtohen me emna ata ishin shumë djem t'mirë. Ishin nga shtatë-tetë vetë me Bruno Selimaj edhe shkum tash na nëpër terrene. I kishin qitë ato pllakatat si këtë anë Robert Doli, n'atë anë {tregon me dorë anën e kundërt} Bushi. E na shkojshim para sabale, bijshum heret. E aty ku ishte Bushi i hiqshum ato e bojshum atë reklamën aty për Robert Dolin.

Në nji kohë, ka pasë ngja n'pesë a gjashtë sahat t'mëngjesit, erdhën sherifat e asaj kohe atëhere e na nxunën. Tha, "Çka jeni duke bo ju kshtu?" Na i themi, "Na jemi me Robert Dolin, dëshirojmë që ai të jetë president". Po thotë, "Po mirë, po kto reklama kto fotografija, ju s'keni t'drejtë me i hekë kto. Mundemi m'i qitë afër tijna, po jo me i hekë". Na edhe ashtu i thamë, "Na, shiko...", "Na mujna me ju arrestu juve". "Na falni se na e dojmi shumë Robert Dolin dhe dëshirojmë që t'bohet president i Shteteve t'Bashkuara t'Amerikës". Tha, "Masi tek jeni shqiptarë, po pshtojmë, ksi heri s'po ju arrestojmë".

Edhe tani m'kujtohet masanena mas krejt këtyne gjanave dulëm secilli për terren, dikush nëpër qytet tjetër, dikush në qytet tjetër, mu ma dhanë nji qytet tjetër, nuk m'kujtohet emni. Tash na u duftke me i thirrë me telefon ata që, "Hajde votoni për Robert Dolin". E kom has në nji, telefon kur kom bo, ishte nji femën aty ajo m'tregoi, "Kisha me ardhë, po e kom nji fmi t'vogël, s'ka kush ma run". Thomë, "Shiko, n'qoftë se ai problem, une e paguj ato". Edhe me t'vertetë (qeshë) e paguva dikon 50-60 dollarë për me ia rujtë fminë, për me ardhë ajo me votu'. Kshtu qì, ne shqiptarët e kena pas nji dëshirë t'madhe. Gzimin ma t'madh që e kena pasë na, e kena pasë kur e bojshum nji mik t'Kosovës, nji mik t'kombit shqiptar, t'Shqipërisë, t'Kosovës, t'krejt trojeve shqiptare.

Kshtu qì, Robert Doli ka qenë mik i joni, nuk ka qenë vetëm ai, e kurorëzoi njifar vend që i thojmë na senator Demata, senator Pearl, Presley, kongresmena Gilman, Longfield, t'gjithë tjerët na kanë përkrahë kur kena dalë në demonstrata. M'kujtohet nji gja tjetër, masi e kryjtëm krejt atë fushatën, ishte ajo convention ashtu t'qujtun. Edhe tash na ishum 60 vetë, u dufke na m'i da detyrat se kush me kenë gazetar, kush me ken diçka tjetër, do t'hotë mu m'caktun si gazetar (qeshë). Shumë interesant atje, ma qitën njifar letër ktu n'gyks edhe osht' *Albanian Journalist*. Me t'vertetë une nuk kisha lindhje me *journalist*

por pak a shumë une dijsha m'u gjetë. Edhe m'kujtohet nji detal shumë interesant, ai si e ka pas emnin ai greku që dojke m'u bo president edhe ai?

Sulejman Gashi: Dukakis?

Shaqir Gashi: Dukakis! Dukakis, edhe tash une si gazetar e marr mikrofonin edhe ia afroj atijna, i thom, "Supozojmë se ju do t'baheni president i Shteteve t'Bashkuara t'Amerikës, çka na thoni ju për Kosovën?" Ai qaq u ofendu' me to sa gati ma thej ashtu atë mikrofonin {ëlevizë dorën}. Tha "Eh who, who is Kosova? Mu nuk m'intereson për Kosovën kurgjo!". Eh e kom edhe nji kujtim tjetër, unë kom kenë në nji tavolinë me Petro Ginion,⁴ Dead Couple⁵ e tonë ata gazetarë botnorë se unë isha gazetar tash, e kom nejtë me nji tavolinë me ta. Kshtu qi, na ma n'fund t'fundit nuk mujtëm me fitu', e fitoi Bushi. Por gjithmonë, gjithmonë e kena përkrahë.

M'kujtohen shumë gjana, fushata ku kena shku' për me *raising money* fushata me pare, me krejt domethanë... Na e kena pasë nji vullnet t'madh! Ku kishim atë vullnet, nuk e di. Po, atë vullnetin me thanë t'vertetën edhe ato ton atë energji, neve na i dha Joseph DioGardi i cili na i hapi dyrtë e asaj kohe për me shku n'kongres e n'senat. E tana që na përkrahshin njerëzit. Une besoj se DioGardi i ka meritat e veta t'veçanta për kohën e caktume. Ai gjithmonë ka, ka, ka luftue, kena shkue. Me DioGardin kom kujtime t'mdhaja, që thash ma përpara kom shkue në vorrimin e Enver Hadrit. Kena shku' n'Gjenevë, kena shku' n'Australi, kado që kena shkue, na kena menu' qëllimi jonë kryesor ka qenë me nxanë nji mik t'Kosovës ma tepër.

Kshtu qi, deri dikun muj me thanë që ia kena arritë, tani masanena tash mujna m'u dredhë aty kah që tham përpara. Domethonë nji gja historike që ishte shumë me randësi dikun kah e '90-ta kur erdh Dr. Rugova herën e parë në Shtetet e Bashkume t'Amerikës, kjo shumë interesant osht'. N'atë kohë n'89-tën malsorët n'krye me Tonin Mirakan, patën bo nji garacion Ibrahim Rugovës edhe Engjëll Sejdës me ardhë në ligjeratat e para të Bogdanit, edhe kurrë nuk e harroj atë gja. Ishte organizu' shumë mirë ata erdhën n'vizitë, por neve se ishum n'kryesinë e lobit, na erdhën disa lajme diqysh shumë t'kqija. Për shembull, mu m'thanë, "Ju nuk guxoni se jeni n'kryesinë e lobit, nuk munesh me shku' me marrë pjesë, se ata i kanë pasaportat jugosllave edhe sigurisht Jugosllavia i ka çu për noj gja t'keqe te na". Kshtu qi, tani edhe anonim ma boni dikush edhe prej misionit shqiptar që ti nuk guxon me shku' atje, edhe kshtu qi une nuk shkova, as unë as Bruno, Bruno Selimaj. Por... gjithmonë m'metke marak pse s'shkum na n'atë tubim.

Kur, t'nesërmit masi u kry ajo ligjérata atje, ai kish pasë shkue n'vizitë te Seli Bytyçi. Kur u përmen Seli Bytyçin, me t'thonë vërtetën ka kontribu' për çështjen shqiptare, n'veçanti Kosovës. Megjithëse me to i kena pasë do dallime, bijshim kshtu u takojshim po kurrë nuk u... miqësia vazhdojke gjithmonë. Edhe ai po m'bon telefon mu, thotë, "Ktu osht' Dr. Rugova me Engjëll Sejdën, ndaqi me ardhë me pi nji kafe,

⁴ Peter Jennings

⁵ Ted Koppel

hajde". P'i thom Brunos, "A shkojmi?" Thomë, "Do t'shkojmi, se s'ma merr menja që na kem shqiptarë t'asi lloji që i ka çu Jugosllavia me na shkatërru' neve lobin shqiptar, me shkatërru' diasporën".

Jena çu une e Bruno, n'asaj kohe Seli Bytyçi e ka pas n'asaj kohe një restorant t'cilin e qujshin "Toskana 54 Room", kena shku' aty, jena njoftu' me Rugovën e me Engjell Sejdën, kena bisedue. Une ia nisa me disa rrotlla ashtu meselet e Drenicës. Edhe kshtu qi, ramë dakord se krejt përgjegjet ishin tana pozitive për kuptimin tem n'asaj kohe. E tash na u bonëm shpejt miq me ta, edhe e vendosëm që t'dalim prej atij restoranti edhe do t'shkojmi në Rainbow Room. Rainbow Room osht' flurosente, osht' një restorant, osht' n'80-tin kat atje edhe atje osht' veni shumë i shtrejtë edhe krejt Manhatanin e sheh kshtu përpara {tregon pëllëmbët}. I shum s'di sa shokë, i patëm edhe disa... m'kujtohet ishte Ramiz Llapatica me neve, edhe ishin do malsorë me neve. Njoni prej neve nuk i kishte ato kpucët, po i kishte ato patikat, e tash na nalt nuk mujshim me hipë pa i pasë kpucat. U detyrum m'i ble edhe njipar kpuca për mos me na u da ai shoku jonë (qeshë).

Edhe shkojmë atje n'Rainbow Room edhe i qesim hesapet tana n'tavolinë. Tash Rugova n'asaj kohe ishte kryetar i... shkrimitar a, ashtu. Edhe kshtu qi na mejher i tregum se na ishim prej lobit shqiptar edhe dëshirojmi që t'i koordinojmë tana kontaktet, "Na informoni se çka po ndodhë n'Kosovë edhe bashkë të punojmi për çështjen e Kosovës edhe të shqiptarëve në Jugosllavi". Rugova ra dakord, i pijtëm disa kafe, e ndrrum hotelin, metëm miq shumë me to, i përcjellëm, ata kanë shumë bashkëpunim t'mirë me disa vende t'tjera. Kshtu qi tani mas disa kohe, dikun kah pranvera e vitit '90-të, situata n'Kosovë u keqësojke ditë për ditë, e Robert Doli e Tom Lantosi e do tjerë na i qujshim kongresmena senatora na ndigjoshin shkojshin vetë për m'i pa situatën n'Prishtinë se qysh po ndodhë atje. Po, ma n'fund t'fundit vendosëm që me ba një dëshmi n'Washington. Edhe i ftojmi të gjithë intelegrjenca e asaj kohe të Kosovës, me Idriz Ajetin me Dr. Rugovën, me Rexhep Qosjën, me Hydajeta Pula, Gazmend Pula, ai Matoshi edhe të tjerë tash nuk muj t'i thom me emra se kanë kenë shumë... Hajrullah Gorani. Edhe tash përgatitem na për kit dëshmi, dëshminë e udhëheqke kongresmeni, miku ma i mirë i shqiptarëve Tom Lantosi, i ndjeri. Tash osht' i ndjerë se ka vdekë. Edhe kshtu qi, u agorizum n'ata, edhe tash bijshin pytjet se kur vjen Rugova me atë delegacion, kush e njeh Rugovën. Dikush prej tyne thotë, "Gashi e njeh se u taku' me to edhe osht' mik me to". Edhe kshtu qi mu edhe State Department-i edhe kryesia e lobi shqiptar m'caktojnë mu që t'jam bashkë me Rugovën aty kur t'vjen me dalë me pritë.

Osht' shumë, nuk e di, njerëzit nuk i dijnë kto gjana. Edhe tash na erdhën ata, dulëm n'Dagllas, jo po n'Uashington m'i pritë, i kena vendosë nëpër hotele. Kena shku' në një dhomë me Rugovën, kur u bo një sahat kanë ardhë ata t'sigurimit e kanë thonë, "E kemi një lajm të keq!". "Çka ka lajm?", thotë "I kemi do lajme se dikush po don me bo atentat në Dr. Rugovën. Edhe duhet me pas kujdes t'madhe", ma bojnë mu. Mu m'kishin caktu aty gjoja si përkthyes pak, edhe qi e njofsha ato, kshtu qi nis m'u kërcënu' situata. Çdo orë vijshin do lajme tjera, une e maj n'men edhe kit gja, për besë lifti kur zbritshim poshtë prej hotelit, u ndrrojke ai lift. Nuk ish i njejti lift, po u duhke tjetër lift për m'u ngjitet nalt për katën e dytë-poshtë. Domethonë, qaq ishte e rrezikshme informacionet që dikush don me bo atentat në Rugovën.

Kur nejse, na rrijshum vigjilent tetonë po nuk dijshum se çka munet me kenë ajo gja. Dikur ma vonë, vjen ma bjen nji letër ata t'sigurimit, me tre emna. Thotë, "Çka domethanë n'kit gjuhën e juve n'shqip?" Aty shkrujke n'ato letra "Jahu, jahe, jahush", tona ishin me mungesën e germave. E une po thom "Tona e kanë njifar kuptimi n'shqip, po nuk di çka domethonë kshtu". "Ani," thotë "veç kujdes". T'nesërmen tani kena shku... nesrit në dëshmi. N'dëshmi ka kenë shumë interesant ajo dëshmi. Afër pesë mijë-gjashtë mijë shqiptarë që kishin ardhë prej tona viseve t'Shteteve t'Bashkume t'Amerikës, për me ditë se qysh do e kalojmë na atë dëshmi. Po, ajo veni i dëshmisë aty ku ishum, ishte veni i vogël, nuk nxake shumë, domethonë ishim bon vakija 60-70 vetë. E tani i maj n'men kur erdhën ata t'Serbisë, ata Karagjoviça ata popat që i qojshin tre gishta. N'njonën anë ishin ata, n'njonën anë ishim na shqiptarët.

E tash filloi ajo dëshmia aty. E tash secili e dhake nji argument, po mu m'kujtohet argumentin ma t'madh, ma t'bindë që e ka pas dhanë n'atë kohë, e ka dhanë Luljeta Pula. Po thom me t'vertetë edhe Rexhep Qosja, po edhe Rugova. Te tanë ai delegacioni jashtë e asaj kohe që kanë ardhë n'Amerikë, simbas mendimit tem, ka kenë bindës. Domethonë e kanë bindë kongresin, e kanë bindë senatin se çka po ndodhë atje. Për shembull, Luljeta Pula e tregojke me argumente thojke, "Helmimi i nxanësve, ekzekutimi i ktyne..." Krejt kshtu qi materialet tjera, na i mujtëm ata. Edhe une muj me thanë aty ish nji, na që i thojmë shqip njifar fjale – U thy aklli. Domethonë prej atyhit na fitum shokë edhe kshtu qi e krymë atë punë. Dulën shqiptarët tonë me na pritë, u gjum tetonë, e selebrojshum atë gja, po tani e kishum preqatitë na edhe nji drekë, nji darkë dikun n'Sheraton Hotel t'cilën kanë marrë pjesë afër dy mijë-tre mijë vetë.

Krejt anëtarët e lobit, me gjithë atë delegacionin u kthyn sa ma shpejtë përmes përgatitë darka ktu n'Sheraton Hotel. Kurse, nji pjesë e delegacionit une me Rugovën e me disa tjerë metëm me ardhë pak ma vonë. Kena shku' n'Hotel, jena çu t'nesrit n'Hotel ata t'sigurimit kanë ardhë na kanë marrë. Kanë ardhë me nji limuzinë t'madhe, une isha me Dr. Rugovën edhe kur kena hi n'kerr atje, na kanë çu te ata tre heronjtë pa emën që i rujnë n'Uashington, edhe kanë dalë na kanë bo njifar respekti bukur t'madh gati si ushtarak. Edhe na me t'thonë t'vertetën u gzojsha tepër, tash e arritëm atë qëllimin masi e kryjtëm atë vizitë.

Ka ardhë ai i sigurimit me telat t'lidhun {tregon me duar gjoksin} edhe po m'thotë mu, "E kom nji lajm t'mirë me ia përcjellë Dr. Rugovës". Thom, "Hajde përhajr koftë", thotë "Prej sodit, osht' president i Kosovës". Thotë, "Pse e kena bo president t'Kosovës, për arsy se kur pe vesum ambasadën jugosllave p'i themi Ibrahim Rugovën..." Na dëgjum që m'i kallxu diçka, "Ata thojnë, 'Po nuk e njohum na ato'. Na e kena vendosë, edhe ti e ki rastin me ia uru titullin për president". Une prej gzimit, ashtu pak kogja shumë... "Ktheu Rugovë se kshtu, kshtu, kshtu osht' puna, prej sodit je president i Kosovës", ia kom uru titullin për president.

Për atë qëllim, për atë që e patëm i thom atyne stafit që ishin t'u na ru, i thomë, "Ma gjoni dikun nji restorant t'bukur, se kom qef me shtru nji darkë, se keni bo munim për neve. Na keni mbështetë, na keni organizu', na keni përcjellë, kom qef me shtru nji drekë". Thojnë kta, "A je i sigurtë që duhet me kon

restoranti ma i mirë?", thom "Po, po restoranti ma i mirë që munet me ekzistu' n'Uashington!". Me t'vërtetë m'vjen keq që ia kom harru' emnin atij restorantit, po ka kenë nji restoran shumë i shtrejtë, domethanë nashta tash nuk osht' mirë me thanë, po nji shishe venë kushtojke nji mijë dollarë e nji pjatë pesëdhjetë dollarë, gjashtëdhjetë dollarë. Por ato shpenzime i lamë sepse une isha sekretar i lobit, i lidhjes qytetare shqiptare e i kisha autorizimin që mujsha me shpenzu' pare. E kom shtru' atë darkë aty, jena knaqë, kena bisedue.

Edhe tash masi e kena kry atë drekën prej atyhit, tash po m'thojnë mu, "Ti ki me shku' m'i nxerrë dy bileta në aeroport, edhe ato bileta mos me qenë as n'emën tond, as n'emën t'Rugovës". Kur kom shku' atje n'aeroport i kom nxjerrë ato biletat, e nuk e di, s'ka randësi sa kanë kushtue, edhe e kom marrë e kom shkrue njonin Sokol, njonin Shpat edhe i kom shti n'xhep. Edhe tash po na përcjellin te aeroporti, ka kenë çudi e madhe, pesë-gjashtë limuzina me drita përpara, pesë-gjashtë përmrapa t'u na përcjellë e t'u i bërtitë me ato hesapet e tyne, ishte shumë interesant. Tani gjatë rrugës po m'tregojnë ata, "Na vetëm Gorbaçovin e kena përcjellë kshtu kur ka pasë ardhë mas pari, tani Ibrahim Rugovën". Edhe tash na po shkojmi atje, kur shkojmë n'aeroplan, ishke n'aeroplan dikun njizet-tridhetë vetë. Hjmë n'aeroplan s'ëm vetë kërkush për bileta, as kurgjo. Dhezshin cigare, secili pijshin duhan edhe i thom Rugovës, "Hajde pe dhezum edhe une e ti, se tanë po pijkan duhan" se atëhere ishte e ndalume me pi duhan n'aeroplan. E dhezëm ka nji cigare edhe po bojmë bisedojmi.

Kur kena zbritë n'LaGuardia Aeroport, ishin dalë me automata {tregon me duar} edhe na rujshin aeroplanin qështu. E tash me ata shokë që ishin t'sigurimit, me ta u bonëm pak si miq edhe po i thomë, "Çka osht' kshtu?", thotë "Kjo osht' se dikush po tenton me i ba atentat Rugovës, edhe kanë dashtë me ru". E tash une pak si me shaka i thomë, "Oj Rugovë, m'fal zoti president, a muj me ta ba nji pytje?" Thotë, "Çka Shaqë?". Thom "A e p'e sheh kta njerëz me automata që kanë dalë ktu?", "Po?", thom "Kta kanë dalë se dikush po munohet me bo ni atentat n'juve. Tregom t'drejtën, a po tutesh?". Ai i ndjeri qeshi pak, nuk m'tha kurgjo, tha, "Po ti a po tutesh?" Thashë, "Une po kom qef me ma ngjitë n'lulë t'ballit se po hi n'istori pa pritë e pa kujtu" (buzëqeshë).

Kshtu qi, dulëm prej aeroportit, më përcjelli prapë me... sigurimi shumë i fortë. Kena ardhë n'Manhatan, tona rrugët u bllokojshin kur shkojshim. Kena shku' n'Sheraton Hotel, kena nejtë aty se ishte darka me u përgatitë aty. Edhe tani, na u vanum pak aty, edhe ata na rujshin te dera sigurimi. Ai pi duhan, unë pi duhan, ish kon pas mushë dhoma plot tym prej duhanit. Kur vijnë ata t'sigurimit, na e çelim derën e timi i duhanit ju shkon kshtu uooop {ilustron kahjen e tymit}, ata kthehen mrapa. Thojnë, "Po s'kena nevojë... duhani po dojka me ju myte juve" Normal dojke me thonë për Rugovën, po edhe për mu qashtu njisoj.

Kshtu qi, zbritëm poshtë atje, ajo ishte nji darkë fantastike që murrëm pjesë qitash, pra dy-tre mijë vetë. Secili e marrke fjalën kur diskutum. Aty ka diskutue Rexhep Qosja, kurrë nuk e harroj, kur e ka thonë nji fjalë, tha, "Ju e keni lshu' Kosovën për punë t'padrejta. Na s'kena mujtë me iu dhanë t'drejta, se s'kena pasë t'drejta as për veti. E keni lshue për arsyet përfundim, ekonomike. Na s'kena mujtë, se s'kena kenë as vetë aty". Kshtu tani te tanë kanë bisedue. Na u çojshim tanë asaj kohe, thojshum, "Kosova, republikë!

Kosova, republikë!" bërtitum, po ata deri dikun nuk mujshin me thonë t'vërtetën, nuk mujshin se kishin m'u kthye përmrapa.

Kshtu qj, ajo vizitë për hesapin tem, ka qenë historike edhe do t'jetë historike. Se, prej atyhit, prej asaj kohe, për shembull vetëm nji detal t'ju tregoj edhe ju e dini mirë. Për shembull, çkado që u bojke n'Kosovë asaj kohe, që u ankojshin Inteleqjenca e Kosovës e asaj kohe, i marrshin ato ankesat e i çojshin n'Beograd. Ai Beogradi kish dhanë urdhën që me i marrë ato gjanat e padrejta e ato sene. Ata shqiptarët e Kosovës u ankojshin n'Beograd. Me atë ditë që u ba ajo dëshmi, mo s'kanë shku ankesat n'Beograd, por kanë ardhë në kongresin amerikan, në senatin. Se tani na, i morrëm, gjithmonë i thirrshum nëpër dëshmia si individë e ku ta di une. Kshtu qj tani ishte puna shumë interesante se fillum me nxanë miq si individuel, për shembull tanë antarët e lobit e nxijshim ka nji mik. Thojke "Ky osht' miku jem. Ai o' miku jem!" Kshtu qj Diogardi nuk ish bash tamon për ato gjana.

Edhe tani i thirrshum njerëzit për me ardhë n'dëshmi. M'kujtohet për shembull, ardhja e Adem Demaçit, edhe ato e kanë pasë thirrë malsorët. Se ktu do flasum, se malsorët po thom t'drejtë, malsorët, malsorët shqiptarë e Malit t'Zi, t'Tuzit, Malësisë, i kanë dalë zot Kosovës ma shumë se sa kosovarët vetë, djem t'pashëm. E tani kanë ardhë me demonstrata, kanë ardhë prej Detroidit, kanë ardhë prej Çikagos, gjithmonë kanë kenë malsorët t'parët në demonstrata kundër regjimit. Tani m'kujtohen njerëz na arritëm shumë gjana, për shembull prej Australie kanë ardhë n'atë dëshmi. Osht' miku jem, vllavi i grusë Besart Krasniqi prej Zelandës t'Re dy herë ka ardhë, e ka pagu' rrugën e krejt, vetëm me ardhë me marrë pjesë në demonstrata. Ai ka kontribu'... nji kontribut t'madh për çështjen shqiptare. Ai ishte edhe miku shumë i ngushtë i Luan Gashit, atëhere kur jonë dalë, kur kanë kenë t'ri.

E kshtu... si me t'thanë bre, jena munu' çdo gja me ba, por kapaciteteti jonë nuk ishte qaq i madh. E m'kujtohet, e kisha nji shok atje që kishum dalë bashkë në kampin kur erdha n'Shtetet e Bashkuara t'Amerikës, ai osht' me origjinë hebrej – *jewish* - mbiemnin e ka Rozemberg edhe ai m'tregojke shpesh herë, m'përcjellke, ishte miku im. Thojke, "O Gashi, ju shqiptarët e keni nji problemin ma t'madh se që jeni ju vetë" "Po çka me bo?" Thojke, "Atëherë problemi ma i madh, ju duhet me nxanë miq. Duhet me pas miq, duhet me lypë". Edhe na qashtu edhe veprum. Nanxum miq, e nxanum mikun ma t'madh në botë shtetin demokratik Shtetet e Bashkuara t'Amerikës, i cili çdo shqiptar e ka borxh me respektue, e mos me harru' kurrë nihmën e Shteteve t'Bashkuara t'Amerikës.

E kshtu tani me rradhë si me thanë, vijshin gjanat t'u u keqësue. E masanena Rugova vijke shpesh herë, shkojke, po nuk ishke mo ai respekti i herës t'parë që ishte përpëra. Mirëpo, unë për veten time edhe mendimi jem nuk o' i vetëm, se na krejt shqiptarët e Amerikës e kena përkrahë edhe e kena dashtë Rugovën edhe e kena respektu', edhe ishte i drejtë për asaj kohe. Unë për veten time flas ktu për Shtetet e Bashkuara t'Amerikës, nuk flas për rajon t'Kosovës se nuk di kurgjo. Po kto që i kom përjetu' vetë, edhe e ka lu nji rol t'madh atëherë, ishte formimi i nënëndegëve të Lidhjes Demokratike ktu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Na Lidhjen Demokratike e kena përkrahë te tanë, mirëpo ishin disa kundërshtarë, se thojshin mos te... ma mirë t'jemi me nji lobi shqiptar që t'mos na ndahet fuqia, t'mos na dahet anena... Kshtu qj, na

fillum me i formu' ato nënëdegët e Lidhjes Demokratike. Shumica thojshin o' gabim, shumica thojshin osht' e qëllume. E kshtu n'fund t'fundit ato na përçanë pak kur erdh ajo situata ma e vshtira për shembull.

E tash duhet të flas për vizitën e Tom Lantosit, delegacioni i Lidhjes Qytetare Shqiptare Amerikane, me Joseph DioGardin dhe me Tom Lantosin në Shqipëri në 1990-tën. Ishin aprovu' te tona hesapet që me marrë me shku' n'Shqipëri, mirëpo ktu ne stafi i Tom Lantosit, kongresmenit, e lypshin nji letër që osht' që po na thirrni me shku n'Shqipëri. Tash për shembull shteti shqiptar e kish shkru nji letër që, "Hajdeni, mirësevini mundeni me ardhë." Mirëpo, kjo nuk ishte bash e përshtatshme për arsyen se kongresi, krejt hesapi e lypshin nji letër pak që po e thrrët Shqipëria për me vizitue shtetin shqiptar mas pesëdhetë vjete. Kshtu qj, e murrën nji letër tjetër, po prapë e kishin pas lanë atë fjalën atje, masi e keni shpreh dëshirën me ardhë n'Shqipëri, na urdhëroni. Mirëpo tani mo nuk u munova se u mërzitsha mos po na shkatërohet kjo vizitë edhe i murrëm me disa shokë t'mi atje, edhe e përmisum edhe e dorëzum, kshtu qj u aprovu'.

Kshtu qj, ajo rrugë ishte shumë interesante se DioGardi me Tom Lantosin shkoi mas pari n'Beograd. N'asaj kohe na e kishum atë radio-lidhjen qytetare shqiptare amerikane, t'cilën e dhashum ato lajmet nji here n'javë. Kshtu qj m'kujtohet shumë mirë, n'asaj kohe Adem Demaçi ishte liru' prej burgut. Tash nuk e di a shumë kohë përpëra. Tash une isha ktu në Nju Jork, ai ishte në Beograd edhe ai e udhëheqte radion prej Beogradit. Edhe na n'minutë, n'atë kohë e kisha intervistën e parë me Adem Demaçin. Për shembull, kujtimet e burgut e çka don me ba tash mas burgut, e ku ta di une. Aty n'atë radion ku punojshim na aty, i kishim miqt aty, na thojshin i keni afër nji qind incizme që po ia u incizojnë këtë far muhabeti. Kshtu qj DioGardi prej Beogradit thojke "*Guess what happened?*" thojke. "Une jom midis Beogradit, Gashi o' atje në Nju Jork. Na e kemi vizitën duhet me shku n'Kosovë, prej Kosove duhna me shku n'Shqipëri". Ajo ishte nji gja e keqe për serbët se nuk i dojshin ato far lëvizje ashtu.

Kshtu qj tani na metëm ktu, kshtu qj na vendosëm, ata u nisën për Beograd. E kryjtëm emisionin me Adem Demaçin edhe u kthym. Tash une u ktheva në restorant edhe po bisedoj me Brunon. P'i thom Brunos, "A s'na duhet neve naj vizë për me shku' tash n'Shqipëri?", thotë "Valla, nuk e ki keq". Shkova e pys atje n'misionin shqiptar, tha "Gashi ju bon vaki që s'keni nevojë me shku' hiç se do t'ju çojmë me nji grup tjetër". Jo une kogja u demoralizova, se kshtu ajo kryesia e lobit m'kish caktu' mu me shku edhe Brunon, edhe Din Derdi. Se Din Derdi ishte që ju kom thonë gjithmonë ka kenë nji aktivist i madh. Ai ishte, nuk ishte bash i dëshirushëm për Shqipëri, se ishte i arratisun kahere. Edhe tani e thrراس DioGardin edhe nji here n'Beograd, edhe terezia që ai DioGardi n'Beograd bisedon me atë Ramiz Alinë. Me siguri ka qenë kjo, nuk e di sigurtë. Kshtu qj, menihere misioni shqiptar thotë, "Hajdeni kur t'jeni t'gatshëm me shku".

Domethanë me fjalë tjera kom kenë jo bash shumë i përgatitun. Kurrë nuk e harroj Gjegj Kalaj na pat pagu' biletën për me shku' n'Tiranë. Jena nisë une, Bruno edhe Din Derdi, i kena hipë aeroplanit edhe kena shku' n... Zyrich. Kur kena shku në Zyrich, atje jena taku' me Hysen Gërvallën, ka thonë, "A po m'merrni edhe mu?" E kena marrë edhe ato, e kena shku' kena hipë n'aeroplan e Din Derdi... kur kena zbritë n'Tiranë, Din Derdi e ka marrë ate e e ka puthë tokën. U ulëm tanë, e puthëm tokën edhe na. Edhe kshtu qj, kishin dalë me na pritë me Mercedeza. Asaj kohe, qeveria e asaj kohe e kish pas një dhetë

Mercedeza ashtu t'bajtun, po t'mirë. Me nji Mercedez kanë dalë, na kanë marrë neve, na kanë çu në Hotelin Dajt. Kurse, Tom Lantosin me DioGardin me stafin e tijna e kishin pas vendosë nëpër villat e Enver Hoxhës.

Edhe kshtu qj, t'nesrit u takum, u bashkum me atë grupin edhe kena fillu' me shku' nëpër vizita. Për shembull, shkojshim atje kah Kruja, Berati, n'Berat na shtrun nji darkë e ku ta di unë. Po ma n'fund t'fundit, për mos me zgatë kto, erdh hesapi, i kryjtëm ato vizita edhe u ndamë në dy grupe delegacioni. Nji grup shkoi te Ramiz Alia, nji grup tjetër une edhe Bruno edhe Rexhë Xhakli te Nexhmie Hoxha në shpinë e Enver Hoxhës ku ka qenë përpara. Me thonë t'vërtetën na ishum pak... e kishum gzimin, e dojshum mbështetjen e shtetit shqiptar, na u doke që osht' nji respekt i madh për neve. Arritëm, e mu m'caktun gati si udhëheqës i atij grupei te Nexhmie Hoxha. Kena shku' aty, na kanë qitë do ambëlsina, na kanë qitë do kafe, kërkush s'ka qenë, vetëm nji njeri me aparat na qitke kshtu {tregon me duar}, me nji aparat me na fotografue. Kena nisë bisedën me bisedue, e kena tregue që vizita jonë e ka qit qëllim me bo marrëdhanie sa ma shpejtë me Shtetet e Bashkume t'Amerikës, osht' interes dy-palësh. Osht' interes n'veçanti për Kosovën, se Kosova osht' e okupume.

E tash ajo Nexhmija ia nisi tha, "Shiko kto janë, Enveri e ka dashtë Kosovën shumë gjithmonë". Thashë, "Edhe na e kena dashtë Enverin, e kena dashtë Shqipërinë (qeshë). Po tash kanë ardhë tjera". Na me fjalë tjera nuk mujshim bash drejtpërsdrejti m'i thanë, po dojshim m'i thanë se komunizmi, ideologjia osht' kah zbehet, osht', nuk osht' mo kurgjo. T'bojmë marrëdhanie sa ma shpejtë me Shtetet e Bashkume t'Amerikës. Kshtu qj ajo tha, "Po, kena fillu' edhe ne do reforma m'i bo, kahere do reforma. Me siguri do t'i bajmë, rinia tash po ka qef me lexu' romanet e Perëndimit e t'Amerikës. Me siguri do t'lirohem pak ma tepër. Ju e dini shumë mirë kur e përzunëm Bashkimin Sovjetik, ato tjera gjanat që i kishum. Shtetet fqinje na izolun, n'vend që me na përkrahë, na izolun ma tepër, e kshtu me rradhë".

Ajo vizitë për hesapin tem, e murrën njifar porosie qj dalë-kadale e kanë ndërmend m'u liru pak prej atij kompleksi, prej asaj ideologjisë. Edhe tani ma në fund u kthym atje, i bonëm disa fotografia, i kom disa fotografia që ndonëse ka nevojë i tregojmi. Edhe tash shkojmi në Universitetin e Tiranës, atje me Tom Lantosin edhe krejt grupin që ishum aty. Kur shkum aty, ata e kishin preqatitë nji vajzë, shumë e bukur, vajza e re. E dijke englishten shumë mirë edhe ia bonën nji pytje kongresmenit. "Zoti kongresmen," thotë, "me ta bo nji pytje". "Urrno," thotë. "Ju mos na tregoni lulen përpara, e thikën përmrapa?" Tash ajo ish nji pytje pak si provokuse, edhe Tom Lantosi po shikon, po na kqyrë kshtu me sy ku jemi, se çka osht' kjo pytje kshtu. Neve ia dhamë njifar sheje që hajt se t'shpjegojmë ma vonë. Kshtu qj, Tom Lantosi i ndjerë e dha nji përgjigje shumë t'bukur. I tha, "Zonjushë, n'qoftëse boni marrëdhanie me Shtetet e Bashkuara t'Amerikës, lulë keni me pas përpara, lulë keni me pas përmrapa. Po a din çka duhet me u bo? Ju duhet me i ujisë lulet" (qeshë). E osht' shumë interesant...

Tani prej atyhit u ndamë edhe tham' tash p'i ia shpjegojmë atijna Tom Lantosit menimet tona që mos t'e sheh n'kusur se kanë kenë nér Kinën, kanë kenë me rusin, kanë kenë përpara edhe me Jugosllavinë. Jonë bo bajat tash nuk p'i besojnë kërkujna (qeshë). Edhe tash po shkojmë n'villën e King Zogut, atje mbretit

Zog. Na kanë shtru' nji drekë shumë t'mirë, jom pa me nji shok temin që s'e kom pa kahere, njeri tash ka vdekë njifar [e pakutpt.]. Edhe e kena marrë rrugën, na kanë përcjellë, mu ma kanë dhanë nji çantë me vepra, me libra të Enver Hoxhës, kurse Tom Lantosit ia falën dy defa. Dy defa, ata i thojshin dajre, na i thojmë defa. Kshtu qi, kur kena shku' në aeroport, ia dhanë dy ... atijna, kshtu i kapke {mbledh grushtin}, mu m'u duke diçka e livdushme defat n'dorë. Shkoj ia marr edhe kongresmeni i thotë Tom Lantosit, "Shiko, kto jonë do gjana antike, jonë shumë interesante, na kto shumë i çmojmë". "A shumë i çmoni a? A don me t'i falë ty?" Une e kisha qëllimin me ia hekë prej dore. E kshtu me rradhë... Kryhet ajo vizitë, edhe tani masanena, të gjithë e dijmi, nuk shkoi gatë tani u shpartallue.

Për shembull, e kom nji kujtim kur na vetshin amerikanët, shpesh here nëpër restorantat e mi thojshin: "Si duket Shqipëria? Si duket Shqipëria?" Na me t'vërtetë qashtu ishum informu'. Thojshim, "Shqipëria osht' si park me lula, dhe me bo me qitë noj gja t'keqe n'rrugë". "Ah" thojke, "t'jesh, t'mburresh me ato". Kur t'nesërmen ata prej ambasadave t'ndryshme qi u shkatërru' Shqipëria, kanë ardhë m'kanë ngushëllu' ata njerëz që ju kom thonë që osht' Shqipëria si park me lula. Edhe...

Sulejman Gashi: Ka pas ardhë nji delegacion gjatë aksionit të pajtimeve t'gjaqeve n'Kosovë edhe n'Amerikë n'vitin 1990? Keni kujtime nga ajo vizitë?

Shaqir Gashi: Ai delegacioni për pajtimin e gjaqeve osht' shumë interesant dhe n'krye me Anton Çettën kanë pas ardhë shumë njerëz. Mark Krasniqi, Anton Çetta, ka kenë njifar Luka prej Pejës, e Azem Shkreli e ai... kanë kenë do tjerë tash s'po m'kujtohet me emër, kena dalë i kena pritë n'aeroport, e prej aeroportit i kena marrë e i kom pru i kom shti n'restorant. E kena shtru nji darkë, kanë ardhë krejt shqiptarët se ishin [e pakuptim.] e ku ta di une. Bajram Kelmendi m'kujtohet shumë moti, e kom nji detal për to. Edhe kshtu qi, na arritëm me pajtu' s'di sa gjaqe ktu n'krye me Anton Çettën. Edhe kur i kryjtëm tanë ato punë, nji detal do t'ju tregoj, tash na shqiptarët aty diaspora ishum përgatitë ma ia u dhonë secilit ka nji gja t'vogël, ka nji pesë-gjashtë qind dollarë sa për rrugë e sa për shpenzime. Edhe tash po i jepum secilit aty për rrugë, edhe une tash i marr ato pesë qind dollarë e po du me ia dhonë Bajram Kelmendit. Bajram Kelmendi nuk tha kurgjo, tha, "Falemnerës". Kur kom shku' n'aeroport, i ka nxerrë ato pare m'i ka kthy. Tha, "Shiko Gashi, a jonë tuat, a i ke marrë prej tjetër kujna, falemnerës une s'kom nevojë për pare". Tha, "Kthehu jepja kto, na keni bo muhabet, na keni pritë mirë". Domethanë ishte nji kujtim i mirë, aty m'kujtohet ajo gja që na kthei paret, nuk deshti m'i marrë. Domethanë ka kenë njeri i mirë, ai tani n'luftë i hupi djemptë, e hupi veten, e i hupi tana, shumë dhimtë e madhe!

Sulejman Gashi: Sot ju keni afrua viteve, moshës 80 vjeç, çka boni sot? Jeni i pensionuar, apo jeni ende aktiv?

Shaqir Gashi: Shiko, me thanë t'vërtetën une nuk kom kenë... nuk kom punu' kurrë punë t'rana, kom punu' n'restorant. Prapë merrna me diçka, djali tash i ka hapë me dhandrrin tim, e kanë hapë nji restorant shumë t'mirë n'qendër t'Manhattanit. I kom dy vajza, e kom Drenushën, e kom Ilirianën e kom Kushtrimen, i kanë krye fakultetet, jonë n'marrëdhanie pune, dikush nëpër biznese, dikush nëpër banka, dikush shkenca politike. Kshtu qi, jom shumë i knaqun me familjen time, edhe jetojmi nji jetë ashtu normale, e

unë po thom t'vërtetën nuk kom kenë qaq i dhanun shumë për punë të biznisit me kenë milioner. Po, une e kom pas nji qëllim se restorantet e mi nuk e di tash me numër, jonë gati njizet e kusur që i kom hapë. Krejt qëllimi jem ka kenë që me ia u dhanë edhe shqiptarëve tjerë, m'u ba sa ma shumë shqiptarë n'biznisa. Kshtu qi, restorantat e asaj kohe të baheshin sikur ambasadorë e kshtu qat qëllim e arritëm. Edhe tash për shembull, porosia ime kish me qenë, që ma s'shumti po m'brengos që për shembull shqiptarët m'u kthye n'atë solidaritetin e para lufës dhe gjatë luftës, kshtu qi me dashtë njoni-tjetrin, m'i përkrahë njoni-tjetrin. Tash diaspora shqiptare, simas menimit tem, i ka kry disa punë t'randa, i ka kry ato punë çka i ka pas me mish e me shpirt i ka bo. Tash une nuk besoj se ka me kenë diçka e randishme diaspora n'lidhje me politikë. Tash s'kemi çka i tregojmë kërkujna, Kosova osht' e pamvarun, i ka institucionet e veta, i ka vështirësitë e veta. Shiko, tash për neve diaspora m'kujtohet, nashta nuk osht' e drejtë me thonë po diaspora m'kujtohet nji shembull p'e jepi, për shembull kur u martojshin bijat tonë, n'a shkojshin te burri edhe u kthejshin n'gjini, thojshin, "Po shkojmë n'opçinë". E ato kur vijshin n'opçinë n'a prujshin kuleçë (buzëqeshë). E tash unë kisha me thanë, n'vend që atë punë diaspora me shku' n'vizitë n'Shqipëri, jo edhe me shku' sigurisht me investu' kah t'kanë mundësi me u kthye, por n'vend të kulaçit, diaspora shqiptare i jetë obligim me investu' edhe me çu pare sa ma shumë.

Sulejman Gashi: A shkoni në vizita n'Kosovë?

Shaqir Gashi: Po, shkoj. N'nji vjet, çdo dy vjet, tri vjet shkoj. Edhe une me thanë t'vërtetën jeta m'ka lind shqiptar dhe dëshiroj që të vdes shqiptar.